



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni Drejtues i Rrjetit për Edukimin Ligjor të Publikut

PROCESVERBAL

Mbledhje e Komisionit Drejtues të Rrjetit Kombëtar për Edukimin Ligjor të Publikut.

Tiranë, më 17.01.2020, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Vasilika Hysi - kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Diskutimi dhe miratimi i Rregullores për organizimin dhe funksionimin e Rrjetit Kombëtar për Edukimin Ligjor të Publikut
2. Vlerësimi i kandidaturave dhe zgjedhja e anëtareve të Bordit Këshillimor të Komisionit Drejtues
3. Diskutim mbi draftin e planit të veprimit të Strategjisë për Edukimin Ligjor të Publikut.

Marrin pjesë: Vasilika Hysi, përfaqësuese e Kuvendit; Evis Qaja, përfaqësuese nga Kryeministria; Rovena Pregja dhe Desara Dushi përfaqësuese nga Ministria e Drejtësisë; Erzen Tola, përfaqësues nga Ministria e Arsimit; Alma Emini, përfaqësuese nga Ministria e Punëve të Brendshme, Blerta Xhako - përfaqësuese e Komisionerit për të Drejtën e Informimit; Iris Aliaj, Këshilltare e Ministrit të Drejtësisë; Urim Bajrami, përfaqësues nga Autoriteti i Mediave Audiovizive; Eda Noçka, përfaqësuese e Qendrës ALTRI; Anisa Metalla, përfaqësuese e T.L.A.S; Ilir Rusi, përfaqësues i Fakulteti i Drejtësisë të Universitetit të Tiranës

Mungojnë: Vildan Kaloshi, përfaqësues nga Këshilli i Lartë Gjyqësor; Ardiana Hala, përfaqësuese e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi;

HAPET MBLEDHJA

Vasilika Hysi – Mirëmëngjesi!

Fillojmë e mbledhjen e Komisionit Drejtues të Rrjetit Kombëtar për Edukimin Ligjor të Publikut.

Të nderuar anëtarë të Rrjetit, meqenëse kjo është mbledhja e parë e këtij viti dhe më lejoni të uroj një vit të mbarë për ju dhe familjet tuaja, si dhe mbarësi në punët e angazhimit tuaja, në mënyrë të veçantë për angazhimin që keni marrë si Komision Drejtues i Rrjetit Kombëtar për Edukimin Ligjor të Publikut!

T'ju them të drejtën, çdo ditë që kalon e ndjejmë se sa rëndësi ka edukimi ligjor i publikut. Kemi kaluar dhe po kalojmë paketa të rëndësishme të ligjeve në parlament dhe po e kuptojmë që miratimi i ligjeve, sado mirë të jenë hartuar ose sado mirë të jenë në përputhje ligjet me interesin publik dhe t'i shërbejnë atij, nuk kanë atë ndikim që duhet të kenë te publiku nëse nuk njihen. Ne e kemi konstatuar këtë problem dhe mangësi, ndaj, ndonëse Kuvendi i Shqipërisë e hap sesionin parlamentar zyrtarisht ditën e hënë, menduam të përfitojmë nga ditët e pushimit për t'u mbledhur dhe për të vënë në rrugë të mbarë punimet e këtij komisioni dhe të Rrjetit.

Këtë vit kemi një vështirësi në lidhje me buxhetimin, unë do të doja t'ju bëja me dije se Kuvendi i Shqipërisë shqyrtoi dhe miratoi në parim një projektligj shumë të mirë për buxhetin dhe ishim shumë optimistë për buxhetin që ishte parashikuar në nivel vendor dhe qendror, por sikurse e dini, programi i rindërtimit, tregon se buxheti ka pësuar ndryshime gjatë diskutimit nen për nen dhe do të pësojë ndryshime edhe gjatë zbatimit të tij, për shkak të fatkeqësisë natyrore që goditi rëndë vendin tonë. Megjithatë ne jemi përsëri optimistë dhe me burimet njerëzore që kemi dhe ato financiare që kanë organizatat, por dhe me bisedat e takimet që kemi pasur këtë periudhë të fillimit të vitit me disa donatorë, të cilët punojnë në Shqipëri, në rast se do të jemi shumë të kujdesshëm dhe do të dimë të koordinohemi mirë, mundet që të gjitha burimet, aktualisht në dispozicion të shoqërisë civile të institucioneve, por dhe me vullnetarizmin që na karakterizon të gjithë, ta bëjmë shumë mirë edhe brenda funksioneve e përgjegjësisë që secili institucion përmbush në vendin tonë. Këtu do të jemi shumë të vëmendshëm dhe do ta diskutojmë në vijim se si mundet që në planin e veprimit të parashikojmë jo thjesht buxhete financiare, pra thjesht para, por edhe kontribute që mund të

japin institucione të ndryshme, duke shfrytëzuar të gjitha kapacitetet, që mendoj se nuk mungojnë në vendin tonë.

Ju e keni marrë rendin e ditës, i cili ka tri çështje. I pari është diskutimi dhe miratimi i “Rregullores për organizmin dhe funksionimin e Rrjetit Kombëtar për Edukimin Ligjor të Publikut”. Kjo rregullore është përgatitur nga stafi i Kuvendit të Shqipërisë, nga sekretariati që na ndihmon dhe është shpërndarë për konsultim publik. Besoj se Iva mund të na sqarojë pak më shumë se si ka ecur procesi i konsultimit publik.

Çështja e dytë është “Vlerësimi i kandidaturave dhe zgjedhja e anëtarëve të Bordit Këshillimor të Komisionit Drejtues”. Ju, sikurse jeni në dijeni, bazuar në Rregulloren e Kuvendit, Kuvendi ka bërë një thirrje publike, që e ka botuar në faqen zyrtare të tij, por e kemi shpërndarë edhe në rrjetet sociale, që të kishim një shpërndarje sa më të mirë.

Sikurse jeni vënë në dijeni edhe nga informacioni i përcjellë nga sekretariati, kam kënaqësinë të konfirmoj se për këtë thirrje kanë shprehur interes 18 persona, me një balancë të mirë gjinore dhe me një shtrirje në të gjitha qytetet kryesore të vendit, ku ka fakultete drejtësie që kanë klinika ligjore. Është barra juaj të përzgjidhni kandidatët më të mirë dhe në vlerësimin tim lista është shumë e mirë, për rrjedhojë ne do të zgjedhim më të mirët, por kjo nuk do të thotë se ata që nuk do të përzgjidhen nuk mund të përfshihen në procesin e zbatimit të strategjisë dhe të planit të veprimit. Kjo do të jetë pika e dytë. Stafi ka menduar që vlerësimi të bëhet me votim të fshehtë, pra më kuti.

E treta është diskutimi për draftin e planit të veprimit, i cili është përgatitur nga Ministria e Drejtësisë dhe besoj se përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë do të na japë pak informacion për procedurën e draftit dhe për procesin e konsultimit publik, ku është përfshirë Rrjeti, sekretariati dhe ku u përfshiva edhe unë për t’i nxitur dhe inkurajuar në dhënien e mendimeve. Këtë proces duhet ta mbyllim sa më shpejt, pasi shumë shpejt do të na duhet të bëjmë një konferencë të donatorëve për të gjetur mbështetje shtesë për planin e veprimit për të ndihmuar dhe inkurajuar të gjitha institucionet, që në pjesën e tyre të buxhetit të parashikojnë edhe veprimtari në kuadër të edukimit ligjor.

A jeni dakord me rendin e ditës? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Fillojmë me çështjen e parë të rendit të ditës “Diskutimi dhe miratimi i Rregullores për organizimin dhe funksionimin e Rrjetit Kombëtar për Edukimin Ligjor të Publikut”.

Fjalën e ka Iva, që është këshilltarja ligjore. Iva, besoj se ju do ta organizoni punën se kush do të flasë!

Iva Seseri – Sipas parashikimit të strategjisë të miratuar me vendim të Kuvendit një nga detyrat e Komisionit Drejtues është miratimi i rregulloreve të Rrjetit. Në muajin nëntor sekretariati teknik ka punuar për hartimin e një draftrregulloreje, i cili iu është përcjellë në fillim të dhjetorit të gjithë anëtarëve të rrjetit dhe në vazhdim edhe Komisionit Drejtues, meqenëse duhej të diskutohej me detaje në këtë komision.

Disa anëtarë të Rrjetit kanë sjellë disa opinione, por mendonim se do të kishte më shumë komente dhe propozime. Kryesisht kanë qenë organizatat e shoqërisë civile, që kanë sjellë propozimet e tyre për disa rregullime dhe ndryshime, të cilat janë pasqyruar edhe në draftin e fundit që ju kam dërguar. Ngelen për t'u diskutuar disa çështje, të cilat mund t'i shohim në vazhdim nen për nen dhe që kanë nevojë ndoshta edhe për mendimin dhe vendimin tuaj. Nuk janë gjëra shumë të rëndësishme, por gjithsesi duan vendimmarrje.

Draftin e keni të gjithë përpara, mund të fillojmë diskutimin, duke kaluar nen për nen, siç e kemi procedurën, pastaj aty ku do të ketë nevojë për ndërhyrje unë do të ndërhyj.

Vasilika Hysi – A keni ndonjë koment në parim për projektregulloren?

Nëse nuk ka a ta miratojmë në parim?

Dakord.

Kush është dakord në parim? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në diskutimin nen për nen.

Të lutem, Iva, fillo prezantimin nen për nen!

Të nderuar kolegë, sipas Rregulloreve të Kuvendit, nëse keni ndonjë shqetësim për përmbajtjen e nenit, ose për riformulimin, ju lutem, prezantohuni, merrni fjalën dhe thoni që jeni, ose nuk jeni dakord për këtë dhe mendoni ta riformuloni.

Nëse do ta bëjmë riformulimin këtu, e bëjmë këtu. Nëse na duhet kohë, sekretariati do të bashkëpunojë me propozuesin për ta përditësuar ose për ta ndryshuar atë për të cilën ju nuk jeni dakord.

Po, Iva.

Iva Seseri – Neni 1 është objekti. Sipas strukturës së çdo rregulloreje fillohet me objektin, se çfarë përcakton rregullorja dhe rregullat kryesore.

Kemi bërë edhe një parashikim, meqenëse çështjet që nuk janë trajtuar mund të na dalin gjatë punës. E kemi lënë t'i referohemi Rregulloreve të Kuvendit të Shqipërisë, që është një akt më kompleks dhe trajton shumë çështje. Nëse ka...

Vasilika Hysi – Kush është dakord me nenin 1, sipas formulimit? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 2, “Rrejtji Kombëtar për Edukimin Ligjor të Publikut”.

Iva Seseri – Neni 2 është një nen i përgjithshëm, i cili jep një përkufizim se çfarë është rrjeti dhe cilat janë përgjegjësitë apo drejtimet kryesore të veprimtarisë së tij.

Vasilika Hysi – Faleminderit!

Të nderuar kolegë, do të doja t’ju tërhiqja vëmendjen në tri funksionet e rrjetit, për të mos u keqkuptuar, sepse ky nen lidhet edhe me planin e veprimit.

Ne si rrjet kemi për detyrë të nxisim dhe të garantojmë bashkëpunimin, si dhe të monitorojmë zbatimin e gjithë këtij bashkëpunimi dhe bashkëveprimi ndër-institucional. Ne si komitet drejtues apo si rrjet nuk kemi përgjegjësi në çështje konkrete të planit të verimit, sepse zbatimi i planit dhe monitorimi është detyrim i qeverisë, i institucioneve, në partneritet me shoqërinë civile. Pra, rrjeti nuk mund të marrë një përgjegjësi që nuk e ka. Ne kemi për detyrë të bashkërendojmë, të nxisim këtë bashkëveprim dhe aty ku nuk funksionon bashkërendimi apo ngrihet shqetësimi se institucione të caktuara nuk i përgjigjen në kohë Ministrisë së Drejtësisë, që është ministria përgjegjëse që do të monitorojë këtë plan veprim, atëherë ne mund të kontribuojmë në funksion, meqenëse përfaqësojmë një organ, që është ngritur pranë një institucioni pluralist, që ka funksione të monitorimit e të kontrollit parlamentar. Prandaj, këto tri togfjalësha i përmenda qëllimisht, për t’i pasur të qarta edhe në diskutimin që do të bëjmë në planin e veprimit.

Neni 3, “Parimet e organizmit dhe të funksionimit të rrjetit”.

Iva Seseri – Këtu kemi edhe një propozim, që te shkronja “d” të shtojmë edhe gjithëpërfshirjen. Është nga një organizatë e shoqërisë civile. Të shtohet edhe gjithëpërfshirja.

Vasilika Hysi – Shumë e saktë. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 4, “Detyrat dhe përgjegjësitë e Rrjetit Kombëtar për Edukimin Ligjor të Publikut”. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 5, “Përbërja e rrjetit”. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 6, “Takimet e rrjetit”.

Në fakt, është lënë që rrjeti të mblidhet të paktën dy herë në vit.

Iva Seseri – Në strategji është “të paktën një herë në vit”, por menduam se rrjeti duhet të jetë më aktiv dhe e kemi lënë të paktën dy herë në vit.

Vasilika Hysi –Është ndryshe nga strategjia?

Iva Seseri– Nuk e kufizon strategjia, por ne e kemi lënë të paktën 2 herë në vit.

Vasilika Hysi – Kam një sugjerim. Në rast se në strategji thuhet “të paktën një herë në vit” dhe ne mund të mblidhemi 2,3,4 herë, t’i qëndrojmë strikt strategjisë. Ne mund të mblidhemi, sikurse u mblodhëm, pa na thënë njeri, sa herë ta gjucojmë të nevojshme. Kështu që, të qëndrojmë në përputhje me strategjinë, “të mblidhet të paktën një herë në vit”. Më pas, në cilësinë e kryetarit të komisionit drejtues, e thërrasim mbledhjen sa herë ta kemi të nevojshme.

A biem dakord? Jeni dakord për çështjet e tjera? E miratojmë nenin 6 me amendimin që propozova? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 7, “Rekomandimet, opinionet dhe deklaratat e rrjetit”. Kjo është shumë e rëndësishme për transparencën. Iva, mund të na thuash, të lutem...!

Iva Seseri - Mund t’i shikoni edhe një herë, nëse ka mundësi, sugjerimet, sepse këto janë aktet që do të nxjerrë në vazhdim rrjeti. Pavarësisht se nuk janë të gjitha specifikisht të parashikuara në strategji, kemi menduar, edhe nga praktika e institucioneve, bordeve apo organeve të tjera konsultuese, që, pak a shumë, rekomandimet, opinionet, deklaratat, do të jenë format me anë të së cilave do të shprehet rrjeti.

Alma Emini – Jam Alma Emini nga Ministria e Brendshme.

Nisur nga nenet e tjera vijuese të rregullores, ku thuhet se kryetari i komisionit drejtues nënshkruan deklaratat apo raportet e rrjetit, në vlerësimin tuaj, mendoj se mund të shtohet edhe hartimi i raporteve. Besoj se do të bëhet nga rrjeti.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord. Nëse...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Te neni 11 thuhet: “Kryetari i komisionit ka këto kompetenca...” Te 1/b-ja thuhet: “Nënshkruan rekomandimet, raportet e opinionit, deklaratat e rrjetit dhe të komisionit drejtues”. I bie që raportet i ka edhe rrjeti. A duhet t’i shkruajmë këtu? Kjo është për vlerësim, ndoshta...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, e kam fjalën referuar...

Iva Seseri – Më specifike, raportet janë. Për shembull, raporti i ecurisë përgatitet nga Ministria e Drejtësisë dhe e miraton komisioni drejtues. Janë më shumë te komisioni të

fokusuara. Megjithatë, mund të kemi edhe ndonjë raport. Kështu që mund ta lëmë të hapur dhe e shtojmë. Nuk na kushton... Pra, tek aktet mund të shtojmë edhe raportin.

Vasilika Hysi – Iva, ku do ta shtojmë raportin?

Iva Seseri – Në formulimin e nenit 7, ndoshta te pika 1 do të bëjmë një shtesë.

Vasilika Hysi – Në fakt, kjo është në përputhje edhe me Rregulloren e Kuvendit, sepse rrjeti (ne jemi të institucionalizuar) do të ketë një qëndrim. Pa dyshim, çdo rekomandim, çdo gjë, duhet të kalojë dhe të miratohet këtu. Nuk mund të kalojë pa u diskutuar mes nesh dhe pa u dakordësuar, për deklaratat, opinionet, raportin për ecurinë...

A biem dakord ta miratojmë nenin 7 me propozimin që bëri zonja Mehmeti?

Erzen Tola – Unë kisha diçka tjetër për vendimmarrjen.

Vasilika Hysi – Po, Erzen. Ju lutem, prezantohuni!

Erzen Tola – Jam Erzen Tola nga Ministria e Arsimit.

Në pikën 2 shikoj që ka dy lloj vendimmarrjesh, si rregull, me konsensus dhe me shumicën e votave. Mendoj se duhet të funksionojmë si organ kolegjal me shumicën e votave të anëtarëve, sepse me duket si evazive... Pra, “Rekomandimet miratohen si rregull me konsensusin e të gjithë anëtarëve ose të paktën me votat e shumicës së thjeshtë”. Nëse do t’i referoheshim ligjit “Për organet kolegjinale”, me shumicë të thjeshtë është normale...

Iva Seseri– E kemi lënë me konsensus, meqenëse është një organ këshillimor. Megjithatë...

Vasilika Hysi – Dakord. Nuk ka asgjë të keqe, por nga përvoja them se në këto çështje gjithmonë ka konsensus, sepse është organ këshillimor.

Në qoftë se biem dakord, e miratojmë nenin 7, më propozimet e zonjës Mehmeti dhe zotit Tole. Kush është dakord? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Faleminderit!

Kalojmë te neni 8, “Komsionit drejtues i rrjetit, përbërja”. Besoj se është përsëri sipas strategjisë. Jeni dakord? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit!

Kalojmë te neni 9, “Bordi këshillimor”.

Kam një pyetje lidhur me pagesën e anëtarëve të bordit. A është përgatitur projektdrafti për Byronë e Kuvendit?

Iva Seseri – Kemi pasur një problem, sepse, kur është bërë parashikimi për vitin 2020, nuk është parashikuar fondi, pasi edhe Komisioni nuk e kishte marrë vendimin për bordin. Vendimi është marrë në muajin tetor, ndërkohë që parashikimet për buxhetin fillojnë

që në muajin korrik. Kështu, për momentin nuk ka një parashikim, megjithatë ne do ta diskutojmë me Sekretarin e Përgjithshëm të Kuvendit që të paktën të gjejmë një mundësi për ta mbuluar me fond për këtë vit.

Vasilika Hysi – Faleminderit!

Unë do t'ju lutesha që ta bëjmë që sot një shkresë me miratimin e Rregullores për mbledhjen e ardhshme të Byrosë, ku bëj pjesë edhe unë, në mënyrë që ta parashtroj në Byronë e Kuvendit.

Atëherë, kush është dakord me nenin 9? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 10. “Mbledhjet dhe votimi në komisionin drejtues”. Zonja Iva, a keni ndonjë një gjë për të sqaruar?

Iva Seseri – Pak a shumë për mënyrën e mbledhjes dhe të thirrjes janë ndjekur parimet e Rregullores së Kuvendit dhe shumica e domosdoshme qoftë për miratimin, qoftë për thirrjen e mbledhjeve. Ka një propozim që, meqenëse do të kemi votime për individë, siç është rasti i sotëm, ky votim të jetë i fshehtë. Pra, në fund të pikës 6 është një formulim: “Për çështje të veçanta me kërkesë të të paktën e një anëtar, komisioni mund të vendosë që votimi të jetë i fshehtë”. Kjo gjë bëhet si rregull, por duhet ta shtojmë edhe këtë formulim.

Vasilika Hysi – Kush është dakord me nenin 10, me propozimin që bëri zonja Iva për të parashikuar votimin e fshehtë, kur kërkohet të paktën nga një anëtar. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 11 “Përgjegjësitë e kryetarit të komisionit drejtues”. A keni ndonjë gjë për të sqaruar, zonja Iva?

Iva Seseri– Këtu janë kompetencat e kryetarit të komisionit drejtues dhe mendoj se janë trajtuar të gjitha detyrat dhe kompetencat kryesore që ka kryetari i komisionit drejtues. Nëse ju keni ndonjë sugjerim, mund ta bëni.

Vasilika Hysi - Po, ju lutem, prezantohuni.

Evis Qaja – Jam Evis Qaja nga Kryeministria.

Shkronja “d” i këtij neni i referohet raportit vjetor që zbatimi i thelbit do t'i dorëzohet për dijeni Kryetarit të Kuvendit brenda datës 31 dhjetor. Duke marrë në konsideratë që raportet e performancës vjetore kanë një periudhë implementimi dhe konsolidimi shkurt – mars të vitit zbatues, mendoj se data 31 dhjetor duhet të zhvendoset minimalisht në muajin shkurt.

Vasilika Hysi – Shqetësimi që ngriti zonja Evis qëndron. Në mbledhjen e ditës së hënë ne do të miratojmë planin e raportimit të të gjitha institucioneve të pavarura dhe si rregull ato duhet të raportojnë në mbyllje të vitit paraardhës, pra në dy –tri muajt e parë të vitit pasardhës. Nëse ne do të ta lemë raportimin brenda datës 31 dhjetor, nuk do të quhet raport vjetor, por i bie të jetë raport 10-mujor. Ky është një problem që buron nga strategjia. Ne mund të themi se do të raportohet brenda muajit shkurt të vitit pasardhës për veprimtarinë e zhvilluar nga data 1 janar deri në datën 31 dhjetor. Kështu do të jemi në përputhje edhe me strategjinë.

A jeni dakord ta bëjmë kështu, zonja Iva?

Iva Seseri – Po.

Vasilika Hysi – Faleminderit!

Kush është dakord me propozimin e bërë nga përfaqësuesja e Këshillit të Ministrave për nenin 11? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 12 “Rendi i ditës i mbledhjeve të Rrjetit dhe komisionit drejtues”. A ka mendime apo sugjerime? Nuk ka.

Kush është dakord me nenin 12? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 13. “Raportimi periodik dhe plani vjetor i punës”.

Ju lutem, me mikrofon.

Rovena Pregja – Jam Rovena Pregja nga Ministria e Drejtësisë.

Thjesht për një saktësim në pikën 2 të nenit 3 thuhet: “Në muajin dhjetor të çdo viti Ministria e Drejtësisë i paraqet komisionit drejtues për diskutim dhe miratim raportprogresin vjetor të zbatimit të SELP në lidhje me planin e veprimit”. A është detyrim i Ministrisë së Drejtësisë që të raportojë në muajin dhjetor?

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Pregja, për komentin! Në nenin 64 të strategjisë thuhet: “Në muajin dhjetor të çdo viti Ministria e Drejtësisë i paraqet komisionit drejtues të rrjetit për diskutim dhe miratim raportprogresin vjetor”. Unë e kuptoj shqetësimin tuaj dhe është i njëjti problem që ne thamë, megjithatë ne do ta lemë në muajin dhjetor, sepse kjo buron nga strategjia dhe duhej të kishin dhënë komentet në atë kohë kur u kërkuan.

Evis Qaja – Kjo mund të vendoset te draftraporti dhe më pas miratimi mund të bëhet brenda dy muajve të parë.

Vasilika Hysi - Atëherë, kush është dakord me propozimin e përfaqësueses së Ministrisë së Drejtësisë dhe përfaqësueses së Këshillit të Ministrave për të ndryshuar nenin 13, duke amenduar pikën 2 të këtij neni? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 14 “Procesverbalet e takimit të Rrjetit dhe të komisionit drejtues”.

Iva Seseri – Edhe këtu ka një propozim lidhur me procesverbalet. Meqenëse ne kemi parashikuar që takimet e komisionit do të jenë si rregull të mbyllura, ka një propozim që edhe procesverbalet të mos publikohen. Pra, të kemi një regjistrim të procesverbaleve, por të mos publikohen, meqenëse kemi diskutime të natyrës teknike, kurse lidhur me procesverbalet e Rrjetit ato janë të detyrueshme për t’u publikuar.

Vasilika Hysi – Po, zoti Rusi.

Ilir Rusi - Jam Ilir Rusi nga Fakulteti i Drejtësisë.

Nëse do t’i klasifikojmë mbledhjet e mbyllura, ato duhet të jenë për çështje të veçanta, jo të karakterit të përgjithshëm. Ne kryesisht do të bëjmë mbledhje të karakterit të përgjithshëm, kështu që në kuadrin e transparencës nuk besoj se duhet të mbeten pa u publikuar.

Nëse do të jemi transparentë, atëherë duhet të jemi në çdo etapë. Pra, nëse ka çështje sensitive që ne duhet t’i diskutojmë, atëherë patjetër që mbledhjet nuk do të bëhen publike, por, nëse janë çështje të karakterit të përgjithshëm, nuk ka pse të mos bëhen publike.

Unë nuk e kuptoj përse procesverbalet nuk duhen botuar? Për të gjitha mbledhjet botohen procesverbalet, si: mbledhjet e Byrosë, Konferencës së Kryetarëve, Komisioneve Hetimore e të tjera, vetëm kur kemi çështje sensitive...

Nuk mund të thuhet “pa praninë e medieve”, sepse nuk prezumojmë faktin që nëse nuk është prezent media nuk zhvillohet mbledhja. Media ka...

Iva Seseri– Jo, jo, kjo është thjesht kërkesa e tyre dhe nuk është kusht për mbledhjen.

Ilir Rusi – Po, pra në këtë sens.

Vasilika Hysi – Unë mendoj se Kuvendi i Shqipërisë ka marrë një barrë, që nuk e merr normalisht. Është strategjia e dytë, pas strategjisë së sigurisë kombëtare që miraton Kuvendi i Shqipërisë dhe ka mbajtur në monitorim, për shkak të rëndësisë që ka.

Ju thoni se procesverbalet publikohen në faqen zyrtare të Kuvendit, në rubrikën e Rrjetit. Pra, kjo është transparencë, sepse njerëzit duhet të dinë se çfarë thuhet dhe çfarë diskutohet.

Ndërsa në lidhje me prezencën e medias, unë pajtohem me shqetësimin që, në kuptimin që sa herë që kemi media në komisione ose grupe pune më tepër bëhet *show* dhe

nuk ka diskutim teknik. Pra, është vënë re që çdo përfaqësues institucioni përpiqet të flasë për të treguar se çfarë bën institucioni. Kjo është në vendimmarrjen tuaj të vendosni.

Iva Seseri –Ne transparencën do ta kemi, sepse pas mbledhjes do të bëjmë një njoftim për mediet, e cila do të jetë në faqen e internetit. Kjo është vendimmarrje juaja.

Vasilika Hysi – Faleminderit, Iva!

Po, zoti Tole.

Erzen Tole – Unë jam dakord me formulimin që është bërë në nenin 18 të Rregullores, ku thuhet: “Mbledhjet e komisionit si rregull zhvillohen të mbyllura”. Unë mendoj se rregullorja është në rregull në këtë formë që është riformuluar, pra mbledhjet mund të jenë të mbyllura, ndërsa procesverbalet të publikohen.

Vasilika Hysi – A jeni dakord? Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kjo shërben edhe në funksion të transparencës që procesverbalet të publikohen në faqen zyrtare të Kuvendit, në rubrikën e Rrjetit.

Iva, kam një pyetje për ty dhe koleget e tjera të sekretariatit, a është hapur rubrika e Rrjetit në faqe?

Iva Seseri – Ne jemi duke punuar me IT-në që të bëhet një *link* i veçantë ku, çdo material që ka të bëjë me strategjinë, të jetë i publikuar.

Vasilika Hysi – Faleminderit!

Kjo është një detyrë e dytë që keni si sekretariat, pra të ndiqni hapjen e faqes së Rrjetit ku do të hidhen të gjitha dokumentet dhe procesverbalet. Gjithashtu, të bëhet edhe njoftimi, pra kur të bëhet njoftimi për mbledhjen e sotme, të thuhet që më shumë informacion do të gjeni në faqen zyrtare të Kuvendit, në këtë *link* dhe secili nga ne ta shpërndajë nëpër institucione, partnerët dhe në rrjetet sociale.

Miratohet neni 14, lidhur me procesverbalet e takimeve të Rrjetit dhe të komisionit drejtues.

Neni 15, “Veprimtari të tjera”. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 15.

Neni 16, “Procedura për zgjedhjen e përfaqësuesve të shoqërisë civile në Rrjet”. Kjo është shumë e rëndësishme. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 16.

Neni 17, “Sekretariati teknik”, të cilin e keni parë, jeni njohur dhe keni qenë në kontakt me çdo informacion. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 17.

Neni 18, “Transparenca”. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 18.

Neni 19, “Faqja e internetit”. Kush është dakord me përmbajtjen e këtij neni? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 20, “Shpenzimet financiare, për funksionimin e Rrjetit”. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 20.

Neni 21.

Iva, a mundet që neneve 20 dhe 21 t’u vendosim nga një titull, sikurse kanë edhe nenet e tjera? Pra, te neni 20 të vendosim “Financimi i Rrjetit” dhe te neni 21 “Rishikimi i rregullores së Rrjetit”. Dakord?

“Pra çdo anëtar i Rrjetit ka të drejtë të paraqesë propozime për ndryshimin e rregullores së Rrjetit, të cilat i kalojnë për miratim Komisionit Drejtues”. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 21.

Neni 22, “Hyrja në fuqi”. “Hyn në fuqi me miratimin nga komisioni drejtues”. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi. Kush është dakord me rregulloren? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit, të nderuar kolegë!

Falënderoj të gjithë përfaqësuesit e Rrjetit që kanë shprehur mendimet dhe sugjerimet e tyre.

Vasilika Hysi – Kalojmë te pika e dytë e rendit të ditës, që është: vlerësimi i kandidatave dhe zgjedhja e anëtarëve të bordit këshillimor të Komisioni Drejtues të Rrjetit. Kush do të flasë për procesin Iva apo Evda? Pra kush e ka ndjekur procesin të bëjë një prezantim të pikës dytë të rendit të ditës.

Evda Mema – Në datën 15 tetor të vitit 2019 Kuvendi i Shqipërisë ka njoftuar hapjen e aplikimeve për anëtarët e bordit këshillimor të Rrjetit për Strategjinë e Edukimit Ligjor të

Publikut. Në përfundim të afatit të aplikimit kanë shprehur interes 18 kandidatë. Përpara keni një përmbledhëse të CV-ve për secilin nga kandidatët, gjithashtu jua kemi përcjellë edhe me *email*.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Nga 18 kandidatë do të votohen 5 kandidatë. Ju lutem, na thoni shkurtimisht për kriteret e anëtarëve që duhet të kemi parasysh në procesin e votimit, sa do të zgjidhen nga universitetet publike dhe sa nga universitetet private, pra çdo gjë në lidhje me kriteret. Ju lutem, na bëni një rikujtesë pavarësisht se janë dërguar edhe në *email*-et e gjithsecilit!

Iva Seseri – Bazuar në vendimin e Komisionit Drejtues, që është miratuar në mbledhjen e parë, është vendosur që bordi të përbëhet nga 5 anëtarë, 3 prej të cilëve do të jenë pedagogë në fushën e të drejtës, pra nga fakultetet dhe nga Shkolla e Magjistraturës, dhe dy anëtarë të jenë ekspertë të njohur në fushën e edukimit ligjor që të kenë ekspertizë.

Pjesa më e madhe e kandidaturave që kanë ardhur, janë nga bota akademike, pra janë pedagogë, por që në punën e tyre ofrojnë edhe ekspertizë, sepse kanë punuar në projekte apo kanë dhënë konsuleca në lidhje me çështje të edukimit ligjor në bashkëpunim edhe me organizatat e shoqërisë civile. Besoj se ju i keni parë CV-të.

Për sa i përket zgjedhjes suaj, mund t'ju rekomandoj se, së pari, ka të bëjë eksperiencia, jo thjesht kohëzgjatja si jurist apo si pedagog, por eksperiencia në çështjet e edukimit ligjor, punimi me projekte të veçanta, nëse kanë marrë pjesë ose kanë hartuar kurrikula. Pra, këto do të jenë kriteret kryesore që duhen parë për kandidatët.

Votimi do të jetë i fshehtë. Ne kemi përgatitur fletët e votimit. Secili prej jush do të zgjedhë 5 kandidatë, meqenëse numri është 5. Në fund do të mbledhen dhe do të dalin votat për secilin nga kandidatët.

Nëse ka dy përfaqësues nga një institucion, duhet të votojë vetëm njëri, sepse anëtari i rrjetit është një votë, sepse Ministria e Drejtësisë dhe Këshilli i Ministrave kanë dy përfaqësues prezent sot. Në parashikimin e Rregullores është që të jetë një përfaqësues i zyrtarizuar nga çdo institucion. Kjo është jashtë diskutimit, por që të mos kemi lëvizje në personat që vijnë, sepse duhet të ketë vazhdimësi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, për sqarimet!

Unë e pashë listën, të cilën e konsultova edhe me sekretariatit. Nuk ka balancë gjinore, ka më shumë gra e vajza sesa burra. Kjo ndoshta tregon se gratë janë më aktive dhe më të përfshira në këto veprimtari, që kërkojnë edhe vullnetarizëm. Megjithatë, kjo është lista. Nga sekretariati është sugjeruar të jetë votim i fshehtë, ku secili nga përfaqësuesit e

institucionit në komitet drejtues do të votojë vetëm për 5 emra, duke pasur parasysh kriteret që thamë. Pra, nuk do të jenë të pestë nga një institucion, nga një fakultet, por një përfaqësues do të jetë nga Magjistratura, dy nga fakultetet publike. Ndërkohë, sa keni lënë nga jashtë Tiranës?

Iva Seseri – Ka pedagogë që japin mësim në disa fakultetet, ndaj nuk arrijmë të bëjmë një ndarje kriteresh, që atje ku japin mësim janë ekspertë apo pedagogë.

Vaslika Hysi – Po, Ilir.

Ilir Rusi – Kam një koment pa e parë fletën e votimit.

Do t'i qëndrojmë në mënyrë taksative shpërndarjes së numrit 5, dy ekspertë dhe tri pedagogë, një nga Magjistratura dhe dy nga fakultetet publike, apo do t'i qëndrojmë rezultatit të votimit?

Nëse do të kemi shpërndarjen e numrit 5, edhe raportin gjinor, duhet që fletët e votimit të jenë orientuese. Pesë që janë vetëdeklaruar ekspertë, por mund të jenë edhe pedagogë, dhe 13 janë deklaruar pedagogë. Në këta të 13-të, që janë deklaruar personel akademik, me kohë të plotë apo të pjesshme, duhet të kemi ndarje sa janë nga Magjistratura dhe sa janë nga fakultetet publike për të shkuar atje ku duhet. Nëse nuk kemi një orientim, nuk shkojmë dot.

Iva Seseri – E thashë edhe një herë, që për ne ishte shumë e vështirë t'i ndanim.

Ilir Rusi – Votimi është votim.

Iva Seseri – Ne i morëm në total, siç ishin të gjitha kandidaturat.

Ilir Rusi – Që t'i qëndrojmë përmbajtjes që kemi vendosur me numrin 5 dhe përkatësitë e tyre.

Iva Seseri – Ky raport është orientues për zgjedhjet që do të bëni ju.

Ilir Rusi – Zonja kryetare, votimi mund të na çojë edhe në 5 pedagogë.

Vaslika Hysi – Faleminderit për çështjen që adresuat, zoti Rusi!

Po, Evis.

Evis Qaja– Unë personalisht e shikoj një qasje të integruar, duke mbikëqyrur edhe më parë CV-të, sepse korniza e propozuar nga pedagogët, që janë edhe ekspertë në raste të caktuara, bën që qasja të jetë e integruar dhe jo statike. Më konkretisht, në pjesën e votimit mendoj se nuk ka nevojë për të ezauruar një orientim më strikt përveç atij që është prezantuar nga ju dhe për të pasur qasjen e integruar, e cila kombinon cilësinë dhe aftësinë e një individi në sektorin privat ose publik në aspektet e mësimdhënies, por, nga ana tjetër, edhe të dhënies së ekspertizës nga një individ. Mendoj se qasja duhet të jetë e tillë.

Vaslika Hysi – Faleminderit!

Do të doja t'ju sillja në vëmendje rolin që ka bordi. Bordi përbëhet nga ekspertë dhe akademikë me përvojë në fushën e edukimit ligjor; ka rol këshillimor, pra do të na këshillojë dhe do të na ndihmojë në plotësimin dhe përmirësimin e politikave. Pra, duhet të jenë shumë më të mirë se ne.

Unë nuk kam komente për kandidatët, por, për të qenë e drejtpërdrejtë, do të doja të theksoja se duhet të jenë njerëz me dëshirë, me aftësi, me kapacitete, me vullnet për të kontribuar. Pra, të mos i detyrojmë ne, siç shkrova unë herën e fundit si kryetare e komitetit, iu përgjigja njerëzve, por duhet të jenë proaktiv. Këtu ka dinamikë.

Ndodhi tërmeti dhe nuk u fokusuam, por në vijimësi do të jemi shumë të fokusuar te kjo çështje. Pra, kërkohet dinamikë. Në votimin që ju do të bëni, siç e tha me të drejtë Evisi, duhet të zgjidhni njerëzit që gjykoni se janë të mirë dhe që do të na këshillojnë, jo t'i këshillojmë ne.

Keni ndonjë shqetësim tjetër?

Ilir, biem dakord që do të votojmë 5 emra me votim të fshehtë, të cilët do të përzgjidhen në bazë të numrit që do të marrin?

Ilir Rusi – Nuk kam asgjë për votimin e fshehtë, por thjesht te numri i votave, do t'i ndajmë apo jo kategoritë?

Iva Seseri – E kam shumë të vështirë në këtë listë të ndaj kush është ekspert. Për ne ka rëndësi që përbërja do të jetë me ekspertë dhe me pedagogë. Kur bëme vendimin, menduam që do të kishim ekspertë të mirëfilltë, por doli që pedagogët ishin ekspertë të mirëfilltë.

Ilir Rusi– Meqenëse është çështje vetëdeklarimi, profesoreshë, ata mund të mos thoshin: “jemi pedagogë”, por “jemi ekspertë të fushës”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, e lëmë të përfshirë, që një pedagog natyrisht është ekspert.

Vasilika Hysi – Dakord.

Pa u vonuar, kalojmë në votim.

Fleta përmban 18 emra.

Ju lutem, të nderuar kolegë, votoni vetëm 5 emra me një kryq brenda kutisë dhe më pas sekretariati do t'i numërojë. Ndërkohë duhet të ngremë një komision me 3 veta Iva, që pjesa tjetër të vijojë me diskutimin në plan...

(Diskutime pa mikrofon)

Një nga komiteti do të vëzhgojë procesin e numërimit, dy nga sekretariati do të numërojnë, ndërsa pjesa tjetër të vazhdojë me çështjen e tretë të rendit të ditës diskutimin e planit të veprimit.

Ju lutem, propozoni një emër!

Mund të zgjidhni më të renë ose më të riun, kjo është procedura në të gjitha Komitetet e Këshillit të Europës apo të BE-së.

Kush është përfaqësuesja më e re në moshë?

Si e keni emrin?

Desara Dushi - Desara Dushi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.

Vasilika Hysi - Në komision do të jenë Desara Dushi, Arlinda Dini dhe Edlira Rama.

Kush do të votojë për institucionet që kanë dy përfaqësues?

(Diskutime pa mikrofon)

Çdo institucion ka vetëm një votë.

(Diskutime pa mikrofon)

Iris Aliaj – Unë jam përfaqësuese e kabinetit...

Vasilika Hysi – Është përfaqësuese e kabinetit të ministres së Drejtësisë.

Ndani fletët dhe fillojmë me votimin...

(Diskutime pa mikrofon)

Do të votojmë këtu.

Nuk ka nevojë t'ju thërrasim emrat, por me radhë siç jemi ulur të fillojë votimi.

Dua t'ju them vetëm diçka. Në rast se keni konflikt interesi, do të ishte mirë ta deklaronit. Ne kemi një Kod Etike, i cili vepron edhe për komitetin drejtues. Pra, nëse keni ndonjë lidhje shoqërore, miqësore, familjare, ju lutem, deklaroni konfliktin e interesit në këtë votim. Do të ishte më mirë që të mos merrnit pjesë në votim se sa të na prishet i gjithë procesi.

Ju falënderoj për mirëkuptimin!

(Diskutime pa mikrofon)

Unë jam tërhequr në dy votime që janë bërë në Kuvend kur kam pasur lidhje shumë të ngushtë. Nëse do të votohej Iliri, të cilin e kam pasur koleg, si dhe kam pasur më shumë komunikim se të tjerët e kam deklaruar konfliktin e interesit...

(Diskutime pa mikrofon)

Për zemër nuk e di njeri që kam. Në rastin konkret i bie që unë të mos votojë asnjëherë, sepse kam kaluar gati 65 mijë studentë të drejtësisë...

Procesi i votimit mbaroi.

Ndërkohë që komisioni do të numërojë dhe do të na japë rezultatin e votimit ju falënderoj shumë për angazhimin dhe seriozitetin e treguar nga ana juaj gjatë këtij procesi, duke uruar që të dalin kandidatët dhe kandidatet më të mira!

Kalojmë në çështjen e tretë të rendit të ditës, diskutimi mbi projektin e planit të veprimit të strategjisë së edukimit ligjor të publikut. Do të doja që përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë të na e prezantonte shkurtimisht dhe të ndalej te shqetësimet që ajo ka dhe për të cilat kërkon një vlerësim nga ana e komisionit drejtues.

Faleminderit!

Rovena Pregja – Faleminderit, zonja kryetare!

Në lidhje me planin e veprimit të strategjisë së edukimit ligjor është detyrimi kryesor që ka tashmë Ministria e Drejtësisë, për të hartuar një plan veprimi dhe për ta dërguar atë për miratim në Këshillin e Ministrave dhe më tej monitorimin e zbatimit të tij.

Sot kemi një draft plan veprimi në përmbajtje të të cilit është përdorur i gjithë imputi bazik i draftit të hartuar gjatë kohës që punohej edhe për strategjinë e edukimit ligjor. Drafti është qasur në formatin, por edhe nga pikëpamja përmbajtjesore me dokumentet strategjike që Këshilli i Ministrave kërkon, sepse drafti paraprak i bërë disa muaj më parë nuk ishte i tillë, kështu që praktikisht nga stafi i ministrisë është bërë një punë shumë e madhe teknike. Është bërë një përmbledhje, konsolidim, ripunim, rivlerësim i masave të draft-planit të parë të veprimit. Drafti që kemi vënë në qarkullim para pak ditësh është ai që e kemi parakonsultuar me të gjitha institucionet përgjegjëse dhe bashkëpunuese të mundshme për edukimin ligjor.

Aktualisht kemi një draft me 39 masa në total, i shpërndarë në 4 objektivat specifike të strategjisë së edukimit ligjor. Drafti u është dërguar për komente dhe për vlerësim të përmbajtjes aktuale të tij të gjitha institucioneve që janë identifikuar nga strategjia e edukimit ligjor. Kam një listë me 36 institucione dhe kërkoj pak edhe konfirmimin e Edës, meqenëse në fillimet e punës keni draftuar draftin. Aktualisht ministria ka marrë përgjigje vetëm nga 18 institucione, pra vetëm nga gjysma e institucioneve të thirrura, ku pjesa më e madhe e këtyre 18 institucioneve janë organizata të shoqërisë civile. Pra, është ky problemi që ne kemi, që institucionet publike dhe ministritë që kanë përfaqësuesit e tyre në Rrjet, nuk janë përgjigjur me komente, vlerësime, me përjashtim të Ministrisë së Turizmit, e cila ka dhënë imput për dy masa, madje edhe të kostuara.

Mund të them që problematikat aktuale të draftit planit të veprimit janë: së pari, ne kemi nevojë të identifikojmë pak më mirë institucionet përgjegjëse, që do të merren direkt me zbatimin e masave konkrete dhe, kur të vijë periudha e monitorimit, t'u kërkohet raportim. Ne kemi vënë në draft se institucioni përgjegjës është Rrjeti, sepse rrjeti është një organizëm i

përbërë nga më shumë se 30 institucione. Nuk mund t'ua ngarkosh me përgjegjësi direkte zbatimin e një mase dhe produktin konkret në fund kaq shumë institucioneve, prandaj ne kemi nevojë të identifikojmë më ngushtë numrin e institucioneve përgjegjëse. Problematikë pastaj është edhe kostoja.

Ju, zonja kryetare thatë në fillim se buxheti i vitit 2020 është pak i vështirë dhe nuk ka parashikuar fonde për këtë fushë përgjegjësie dhe ky është problem.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Deri tani kjo na rezulton si dobësi për problematikat e draftit. Pra, nëse institucionet mund të shprehen në përmbajtje, ose të përmirësojnë përmbajtjen e një mase, ose të parashikojnë produkte konkrete, nuk shprehen, nuk japin një kosto, sepse thonë që nuk jemi parashikuar në buxhet. Kjo në një farë mënyre i pengon ato të ulen të llogarisin sa mund të kushtojë një aktivitet i caktuar ose çfarë duhet të parashikojnë në funksion të aktiviteteve për të arritur objektivat përkatëse të strategjisë.

Një problem tjetër teknik i draftit, i cili ecën paralelisht me parashikimin e aktiviteteve dhe masave është edhe koha e zbatimit, sepse strategjia është 19/23, plani i veprimit 19/23, por këtu do të bëjmë një ndryshim, sepse jemi në vitin 2020 dhe plani i veprimit do të dalë me kohë zgjatje vitin 2020-2023. Edhe Këshilli i Ministrave nuk do ta pranojë që në vitin 2020 të miratojë një akt që të parashikojë veprime për vitin e kaluar.

Pra, dua të them se fakti që ka një kohëzgjatje 3-vjeçare, teknikisht është problem nga të gjithë propozuesit dhe institucionet që kanë parashikuar masa ose mund të vlerësojnë fillimin dhe mbarimin e tyre. Pra, duket sikur e kanë më të thjeshtë të thonë që ky aktivitet fillon në vitin 2020 dhe mbaron në vitin 2023. Kur ne të ulemi të bëjmë monitorimin, të hartojmë raportet 6- mujore, duket sikur një masë e caktuar mund të dalë në statusin në proces. Kjo është diçka shumë teknike, por do ta cenojë raportin në fund.

Draftin aktual, që ne kemi në tryezë, ministria do ta riqarkullojë edhe brenda ditës së sotme për komente, impute, vlerësime nga institucionet.

Vasilika Hysi - Po, zonja Noçka, pastaj zonja Mehmeti.

Eda Noçka – Unë do të doja të ndalesha pak në tri problematika. Për institucionet përgjegjëse në draftin aktual Rrjetit i ngarkohen shumë aktivitete. Në fakt, është një zgjedhje që është bërë në draftin e fundit, mbi të cilin është punuar, sepse në draftin fillestar Ministria e Drejtësisë ka pasur përgjegjësinë kryesore të zhvillimit të aktivitetit, përveç objektivit 2, ku Rrjeti kishte dhe aktivitetet më të shumta.

Sa u përket financave, që kur është hartuar strategjia, është mbajtur në konsideratë që plani i veprimit të kalonte në një kohë kur ishte e mundur, do të thotë afati maksimal i

miratimit të planit të veprimit të ishte atëherë kur diskutohet buxheti. Natyrisht, është menduar që në atë kohë shumë nga masat të mos kenë impakt në buxhetin e shtetit. Pra, një pjesë e mirë dhe mund të them 80% të masave nuk kanë impakt në buxhet, pjesa e kostove që ne kemi paraqitur është më shumë një orientim për donatorët, nëse ata do të duan të mbështesin aktivitete të caktuara dhe të lehtësojnë ngarkesën e institucioneve publike. Ndaj edhe mendoj që pjesa buxhetore nuk e pengon realizimin e aktiviteteve, por ka edhe një kosto që orienton donatorët, nëse do të duan që të mbështesin aktivitete të caktuara për të lehtësuar punën e institucioneve publike, pasi, përveç dy masave, shumica mund të bëhen me kapacitet që kanë institucionet.

Gjithashtu, ne i kemi drejtuar Ministrisë së Drejtësisë dhe në mbledhjen e komisionit të fundit drejtues është thënë që është parashikuar në buxhet një kosto për zbatimin e planit të veprimit të strategjisë së edukimit ligjor të publikut, meqë ishte mbledhja e fundit e Rrjetit.

Gjithashtu, ne edhe nga monitorimi që i kemi bërë buxhetit të Ministrisë së Drejtësisë kemi marrë njoftimin zyrtar se ka një shumë të tillë. Po t'i hyjmë zë më zë ne nuk e gjemë atë shumë, por mendojmë se te "ndihma ligjore falas" mund të jetë një komponent që mund të mbulojë edhe zbatimin e strategjisë duke qenë se kuptojmë shumë mirë që plani i veprimit nuk është miratuar dhe sa nuk është miratuar, nuk mund të ketë zë të veçantë në buxhet.

Vasilika Hysi– Po.

Eda Noçka - Plani i veprimit nuk është miratuar, por gjatë fazës që është në proces për t'u miratuar dhe ne duhet të konsolidojmë të gjithë draftin , që do të thotë se duhet të përfshijmë në të të gjithë informacionin, dhe një nga informacionet është edhe ai financiar, Ministria e Drejtësisë për çdo informacion dhe çdo blerje që do të vendosë në këtë dokument duhet t'i ketë ato, sepse është Ministria e Financave që i kontrollon, është Kryeministria që do t'i vlerësojë para se akti të futet për miratim në mbledhje të Këshillit të Ministrave.

Ajo që ju thatë se Ministria e Drejtësisë ka një buxhet të caktuar për këtë, mua më duhet ta verifikoj, dhe ta implementojë në draft. Nuk flas për ndihmën ekonomike, sepse ndihma juridike është drejtori në varësi, që ka buxhetin e saj dhe këtu është direkt përgjegjës për aktivitetet e veta. E kisha më tepër shqetësimin për ato që janë të Ministrisë së Drejtësisë, si institucion mëmë i ndihmës juridike.

Vasilika Hysi - Faleminderit!

Eda Noçka – Për sa i përket kohëzgjatjes, meqë ishte një nga problematikat e ngritura, është e vërtetë që disa nga masat kanë pasur si afat realizimi vitin 2019, megjithatë, kur janë bërë pasaportat e indikatorëve, të gjitha këto masa kanë kaluar për vitin 2020, sepse ne e pamë që plani po vonohej dhe nuk do të ishte i mundur realizimi i tij. Nuk ka masa në

planin që kemi propozuar për periudhën 2020-2023, janë me vite konkrete përveç objektivit 4, i cili është në vazhdimësi, sepse janë fushata ndërgjegjësimi dhe advokimi që do të kryhen në vazhdimësi, por masat e tjera janë me vite të caktuara, ndonjëherë edhe 3 - mujore apo 6-mujore.

Vasilika Hysi -Faleminderit!

Fjala për zonjën Mehmeti.

Alma Mehmeti – Ne do të donim të ishim pak më aktivë si ministri në dhënien e mendimeve të planit, por unë realisht kam pasur vështirësi me orientimin. Di që Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka një sërë aktivitete që i kryen në vazhdimësi, por e kishte të vështirë të planifikonte qoftë edhe me buxhet, qoftë edhe me masa konkrete apo të thoshte që brenda këtij viti kemi këto, sepse ka vështirësi në identifikimin e afateve, apo të buxhetit, i cili është kryesisht i policisë apo me mbështetjen e PAMECA-s. Unë do të doja të ishte zhvilluar një takim paraprak, jo vetëm komunikim me *e-mail* për planin e veprimit, sepse patëm vështirësi, thjesht mora komunikimin me të gjithë, por nuk kisha një imput që t'ua dërgoja, se u bë disa herë.

Pastaj kishim një problem tjetër, se ne jemi ministria përgjegjëse për politikën, pavarësisht se në Rrjet janë vetë shoqatat dhe çështja është kur pushteti vendor ngarkohet me detyrime apo me buxhet edhe pse miratohet nga Këshilli Bashkiak, është sugjeruar që para miratimit, plani të konsultohet me Këshillin Konsultativ që të japë një mendim paraprak para se të finalizohet drafti.

Zonjë – Ju falënderoj, kryetare!

Do të doja të falënderoja Ministrinë e Drejtësisë dhe ekipin që ka punuar për draftin edhe me suportin nga shoqëria civile për të organizuar dhe bërë një draft të konsoliduar, ose më saktë një dokument të strukturuar. Për fatin e mirë kemi qenë në bashkëpunim edhe në komunikime që në dhjetor me Ministrinë e Drejtësisë për të orientuar ministrinë. Në fakt, ekipi është i orientuar, sepse ka eksperiencën për hartime dokumentesh edhe në fusha të tjera, siç janë drejtësia, reforma në drejtësi apo antikorrupsioni e të tjerë, në kuadër të standardizimit dhe formateve që ne kemi si qendër qeverisjeje, por edhe Këshilli i Ministrave edhe ne si departament orientojmë për hartimin e dokumenteve strategjike dhe planeve të veprimit.

Komenti ynë i parë ka qenë fillimisht në kuadër të strukturimit të planit të veprimit, ku shohim që një pjesë e mirë e komenteve janë reflektuar. Ajo që sugjerojmë në varësi të tri çështjeve që do të doja të parashtroja, por në fakt edhe Rovena i trajtoi në diskutimin e vet, lidhet me pjesën e riorganizimit fillimisht të brendshëm, që ka nevojë për një trajtim pak më

specifik teknik, dhe më pas takime, të cilat kanë nevojë të bëhen në tavolina rrumbullake dhe jo pjesë *e-maili* në mënyrë që të diskutohen masat.

Tri çështje do të donim të identifikonim në kuadër të fazës, që është aktualisht plani i veprimit. Së pari, është identifikimi i institucioneve, që u prezantua edhe nga Rovena, si përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë, u konfirmua edhe nga Eda, që ekziston një lloj “antikapi”, për identifikimin e institucionit që e implementon. E thënë kështu, është bërë puna e duhur për të identifikuar institucionet. Mendoj që duhet ta nisim ndryshe, ndoshta ka nevojë për identifikimin e institucionit, të riformatohet pjesa e masave ose e aktiviteteve, që do të thotë gjithë nënobjektivat specifikë në kuadër të qëllimeve të politikës të ribëhen edhe një herë në mënyrë që të jenë të matshme dhe të identifikohen me programet buxhetore, që implementojnë institucionet. Thënë kështu, mund të jap një rast shumë konkret për ta bërë më specifik sugjerimin dhe rekomandimin që po japim: masa, e cila lidhet me 12/1 me objektivin specifik rritjen e vazhdueshme të burimeve financiare nën qëllimin e politikës së parë, që lidhet me përmirësimin e organizimit dhe funksionimit institucional në ofrimin e edukimit ligjor publik, identifikon disa masa, mes të tjerash, krijimin e *database* të donatorëve që ofrojnë *helping*. Këtu është vendosur që Rrjeti do të jetë institucioni përgjegjës. Në institucionin kontributor ka vendosur Kryeministrinë dhe Ministrinë e Financës. Ka lidhje apo s’ka lidhje, kjo duhet diskutuar me financën. Financa si funksion bazë, mes të tjerash, ka edhe koordinimin e donatorëve. Mendoj se kjo duhet diskutuar edhe me financën edhe për të parë qasjen, edhe për të vendosur masën se çfarë do të jetë. Përderisa financa ka si funksion kryesor koordinimin e donatorëve, ata kanë edhe një *database* të caktuar. Kështu që mendoj se bërja e një *database* në vijim e koordinuar nga financa në bashkëpunim me aktorë të rëndësishëm si: Kryeministria, Integrimi e të tjerë, duhet riparë. Pra, që nga pikëpamja e vendosjes lë për të dëshiruar. Po t’i kalojmë të gjitha nen për nen kanë të tilla problematika. Ne ia kemi dhënë komentet Ministrisë së Drejtësisë, edhe formalisht, me qëllim që të ribëhen dhe të riorganizohen masat fillimisht si koordinator nga Ministria e Drejtësisë dhe më pas takime bilaterale ose takime tavoline grupi pune për të qartësuar masat që do të identifikohen.

Kaloj te rekomandimi i dytë: një nga propozimet e bëra nga ne edhe në përputhje me metodologjinë dhe standardizimin e kuadrit strategjik dhe planit të veprimit është që masat nuk duhet të jenë *wishing list*, por duhet të jenë të identifikuar konkretisht në programet buxhetore të çdo institucioni, i cili bën edhe diferencimin në kuadër të angazhimit që ka, por edhe buxhetin që ka planifikuar për periudhën 2021-2023 në programin “Planifikimi buxhetor afatmesëm”, që do të fillojë tani, kështu që jemi në kohën dhe në momentin e duhur.

Pjesa e afatit kohor, jam shumë dakord, jam shumë dakord, kjo është e treta, që doja të jepja, duhet të identifikohet minimalisht, dhe ekipi i Rovenës e i Ministrisë së Drejtësisë ka gjithë eksperiencën për ta ndarë me tremujorë, pra për të vendosur një *start point* dhe një *end point* për t'i identifikuar pastaj te raporti i monitorimit se cilat janë masat, cilat nuk janë zbatuar, shkaqet, rreziqet e të tjera, për t'i adresuar te raporti vjetor i performancës.

Këto ishin tre çështjet, të cilat kishim dëshirë t'i identifikonim, por jemi në një linjë edhe me kolegët, të cilët kanë punuar e që do të bëjnë punë të mirë edhe në vijim.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Ka ndonjë mendim tjetër?

Më lejoni të them edhe unë dy fjalë.

Unë e lexova planin e veprimit, dhe pajtohem me të gjitha diskutimet, që i adresoi me të drejtë zonja Pregja, por dhe që i konfirmuat edhe ju, të nderuar kolegë.

Në fakt kanë dalë disa probleme dhe unë do të doja që ne, si rrjet, si komitet drejtues i rrjetit, mund ta ndihmojmë Ministrinë e Drejtësisë. E them këtë, sepse e kemi detyrim në kuadër të strategjisë.

Së pari, të gjithë biem dakord se koha e zbatimit do të jetë 2020 - 2023.

Së dyti, unë do të doja që, në emër të komitetit drejtues, sekretariati të përgatisë një letër, e ta firmos unë, Iva, të cilën t'ia drejtojë Ministrisë së Financave, me qëllim që të kemi një diskutim bilateral në fillim të planifikimit buxhetor afatmesëm, ku ne të prezantojmë strategjinë dhe nevojat që kanë. Unë pajtohem me atë që tha zonja Noçka, se shumica e projekteve, e veprimtarive, nuk kanë nevojë për buxhet.

Më lejoni t'ju bëj me dije se vetëm dje, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi më ka informuar në lidhje me një aktivitet intensiv informim, sensibilizim në të gjithë Shqipërinë, në kuadër të dhjetëvjetorit të ligjit Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Nuk kishte nevojë për fonde. Kërkonte praninë tonë, të ishim të pranishëm nëpër qytete, për të folur e prezantuar. Aktualisht, institucioni i ka paratë.

Unë shoh se ai nuk ka dhënë komente dhe nuk ka parashikuar buxhet, gjë që do të thotë se lidhur me institucionet përgjegjëse, pajtohem me takimet bilaterale.

Që sot, Iva, ne do të bëjmë nga një letër, në kuadër të mandatit që kemi, të kontrollit parlamentar, të gjitha institucioneve që raportojnë në Kuvendin e Shqipërisë, e që lidhen me edukimin ligjor, duke filluar nga Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, të gjitha institucionet që lidhen me edukimin ligjor, me këtë strategji, që të na paraqesin planin e aktiviteteve, që planifikojnë të zhvillojnë në vitin 2020, buxhetin dhe donatorin. Pra, ata nuk do të nxjerrin

para të tjera, por unë di se Avokati i Popullit ka shumë aktivitet, komisioneri ka. Le të na i japin në një fletë, në një dokument, dhe ne do t'ia përcjellim Ministrisë së Drejtësisë. Do t'u themi se kjo do të bëhet me qëllim që të përfshihen në planin e veprimit. Në këtë mënyrë, ne ndërthurim strategjitë, shmangim mbivendosjen dhe prodhojmë sinergji.

E dyta, me të gjitha institucionet që nuk kanë dhënë përgjigje, do të doja që, nga sekretariati, dikush nga ju, jo gjithmonë Iva, sepse ajo ka edhe angazhime të tjera, në kuadër të paketës penitenciare, të cilën do të fillojmë ta diskutojmë sot, të kishim listën e organizatave që nuk janë përgjigjur në konsultim publik, një letër për ministren e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin.

Këtu do të doja nga ju, zonja Prega, që të më thoshit se cilat nga ministratë nuk janë përgjigjur. Që sot, unë do të bëj një letër për Ministren e Shtetit, me cc, Sekretarit të Përgjithshëm, zotit Agaçi dhe juve, për t'i sensibilizuar, me qëllim që kur ka një plan veprimi të raportojnë.

E treta, me të drejtë e tha Alma, se Ministria e Brendshme ka shumë aktivitete. Unë marr vazhdimisht ftesa, dhe ose përshëndes, ose jam e pranishme. Vetëm projekti SIDA mbulon të gjithë paketën e edukimit ligjor për policinë, viktimat, të miturit, gratë e të tjera.

Pra, Ministria e Brendshme nuk ka nevojë të nxjerrë para, por nga paketa që ka kaluar në Kuvendin e Shqipërisë, shumë të cilën e kemi miratuar ne, e që është gati 3 milionë euro, duhet të thotë se në vitin 2020 Akademia e Sigurisë ka këto aktivitete, komisariatet kanë këto, Komiteti i Helsinkit e LGBT-të kanë këto, Helsinkit holandez, sepse ju keni një projekt me ta, në shumë aktivitete të të cilit kam qenë e pranishme, PAMECA ka këtë, ICITAP-i ka këtë.

Pra, në qoftë se nga planet aktuale të veprimit nxjerrim listën e aktiviteteve, për shembull, sikurse tha Evi, në muajin mars, me dymbëdhjetë komisariatet, plani për LGBT-të, të miturit, trajnimi i punonjësve të policisë në këto komisariate, shumat i merr nga buxhetet e tyre dhe i vendos këtu, mendojmë se shmangim edhe mbivendosjet, edhe jemi transparentë, edhe bëjmë një listë të aktiviteteve. Pastaj do të shikojmë se ku ka nevojë për të ndërhyrë: te konsumatori, te njohja e edukimit ligjor?

Ju keni Klinikën Ligjore. Ministrja Gjonaj, të paktën në takimin që pata pas Vitit të Ri, më tha se ka parashikuar buxhet për Klinikën Ligjore dhe Drejtorinë Juridike. Ju do ta parashikoni. Buxhet i qeverisë, në kuadër të Klinikës Ligjore, por ne e dimë se ka një buxhet. Është edhe njohje e vlerës që ka, por as nuk bëjmë mbivendosje.

Prandaj, një listë të të gjitha institucioneve, të cilat nuk janë përgjigjur, si dhe një letër, besoj se biem dakord që duhet t'i bëjmë në emër të Komitetit Drejtues, për Ministren e Shtetit për marrëdhëniet me Parlamentin.

Unë do t'ju sugjeroja, zonja Pregja, një takim bilateral kokë me kokë me të gjitha institucionet.

Po të shkoi te Ministria e Arsimit, po të flisni me Zamira Gjini dhe përfaqësuesen që ka Ministria e Arsimit në Këshillin e Europës, në ato komitetet e arsimit të të rinjve e të tjera, një zonja grua, eksperte, do të shikoni se sa shumë aktivitete me fondet e tyre, si dhe projekte që kanë. janë projekte pa fund. Ne marrim informacion. Të njëjtën gjë mund ta bëjmë për...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, sugjerimi im është... Ne jemi shumë burokratikë, komunikimi me e-mail nuk funksionon. Meqenëse Kuvendi e ka marrë përgjegjësinë që të koordinojë, bëjeni këtë përpjekje. Do të harxhoni pak kohë, por duke u ulur konkretisht me Almën dhe me përfaqësuesit e projekteve në ministri, për tre-katër orë, duke bërë të njëjtën gjë edhe me Kuvendin. Unë kam thirrur në Kuvend donatorët që kemi. Takimin me ambasadën zvicerane e takova, e konsumova, i kam marrë një miratim në parim; me OSBE-në dhe NDI-në, që kanë një projekt prej afro 6 milionë frangash, ku përfshihet edhe edukimi civil e qytetar, e kemi lënë për javës tjetër. Do të nxjerrim listën e aktiviteteve që mbulohen nga PACEK, nga projekti që ne kemi, edhe çfarë do të mbulohen nga fondet e Kuvendit. Kësisoj, edhe pjesën tonë e kemi të mbuluar shumë mirë. UNIM e ka lënë zonja Gjermani.

Kemi edukimin ligjor, barazinë gjinore, janë shumë projekte. Mjafton që ne t'i hedhim dhe të bëjmë një transparencë të të gjitha investimeve.

Lidhur me shoqërinë civile. Anisa, ju jeni përfaqësuese e shoqërisë civile. A është e mundur që, si anëtare e komitetit drejtues, të bëni një takim, nëse bien dakord edhe kolegët e tjerë, me të gjitha organizatat, të cilat punojnë në objektivat që ka strategjia, për të thënë: në vitin 2020, ky donator ka këtë aktivitet, me këtë shumë. Qendra e Nismave Ligjore Qytetare ka këtë projekt, me këtë shumë, UNDPI-ja ka këtë?

Unë mendoj se po ta bëni këtë gjë, brenda një jave ose 10 ditësh këtë plan veprimi do ta kemi aq të detajuar, aq të mirë dhe do të jetë model.

Do të doja që secili prej jush, në fushën që vepron të marrë një përgjegjësi.

Eda Noçka - Faleminderit!

Mendoj që sugjerimi juaj gjen vend njësoj si për institucionet shtetërore, edhe për organizatat që kanë plot projekte që implementojnë dhe kanë në fokus edukimin ligjor. Kam përshtypjen se ju i kemi paraprirë një diçkaje të tillë dhe mund të keni goxha informacione edhe nga komunikimet që ne ju kemi nisur më herët. Për shembull, unë vetë kam përgatitur

një informacion të detajuar me projektet që implementojnë dhe me numër të saktë, (kaq trajnime në kaq rrethe ose takime me nxënësit në kaq rrethe në këtë periudhë).

Pra, një informacion të tillë sekretariati duhet ta ketë, të paktën, për ato organizata që i janë përgjigjur thirrjes suaj. Sigurisht, ne nuk jemi kundër me pjesën më të madhe të organizatave, që janë këtu dhe kanë sjellë informacion për të gjitha aktivitetet e tyre. Dua të theksoj se organizatat nuk kanë projekte kaq afatgjata, siç kanë institucionet shtetërore. Ne operojmë përmes granteve dhe një pjesë të angazhimit që kemi njoftuar e shikojmë edhe në bazë të perceptimit ose ku e shikojmë veten tonë në të ardhmen, për shembull, ne nuk kemi projekt për vitin 2023, por ne shikojmë se, duke qenë, për shembull, se kemi investuar për mbrojtjen e fëmijëve ose kemi implementuar 2-3 projekte kohët e fundit dhe kemi trajtuar për çështjen e edukimit ligjor, shohim si objektiv që në të ardhmen mund të kemi ose mund të shkruajmë projekte ose mund t'i përgjigjemi thirrjeve në këtë fushë.

Për shembull, për vitin 2020 jemi të qartë dhe është një informacion që e kemi dërguar, se kemi projekte dhe çfarë kemi për të bërë i kemi nisur, prandaj mendoj se shumë e thjeshtë për organizatat për ta ndarë këtë lloj informacioni.

Vasilika Hysi – Do të doja kontributin e Ivës, nëse materialet që unë kam kërkuar janë prezantuar apo reflektuar në planin e veprimit, apo jo?

Iva Seseri – Një ndërhyrje lidhur me informacionin e dërguar nga anëtarët e rrjetit për aktivitetet që kanë parashikuar, gjë e cila u la si detyrë në takimin e parë të rrjetit. Ua kemi kërkuar anëtarëve të rrjetit këtë informacion dhe e kanë sjellë 5-6 prej tyre. Kemi bërë një tabelë, të cilët do t'ua shpërndajmë sot, sepse prisnim akoma kontribute.

Rovena Pregja - E nderuar kryetare,

Dua të shtoj diçka për sa u diskutua. Duke u bazuar në të gjitha detyrimet që Ministria e Drejtësisë ka në kuadër të strategjisë së edukimit ligjor, aktualisht unë kam realizuar disa takime me organizata ndërkombëtare, të cilat ofrojnë fonde për organizatat e shoqërisë civile dhe kam kërkuar një informacion të detajuar lidhur me të gjitha projektet që ato kanë, jo vetëm për ato projekte që lidhen me fushën e veprimtarisë së Ministrisë së Drejtësisë, nga njëra anë, por, nga ana tjetër, edhe me ato që lidhen me edukimin ligjor të publikut. Sapo ne të kemi informacionin, do të hartojmë edhe një dokument në lidhje me këtë (cilat janë projektet, ku janë qytetet në të cilat këto projekte po zbatohen). Informacionin do t'ia ndajmë edhe sekretariatit dhe mendoj se kjo gjë mund të shërbejë për atë çështje, të cilën ju ngritët për diskutim, pra që të kemi një informacion të detajuar për të gjitha organizatat, të cilat janë zbatuese të këtyre projekteve, me qëllim përfshirjen e tyre edhe te plani i veprimit të strategjisë.

Vasilika Hysi - Faleminderit!

Unë kam një sugjerim konkret për Ministrinë e Drejtësisë. Nëse do të isha në vendin tuaj, çfarë do të bëja? Ju kërkoj ndjesë, por ne jemi një grup teknik pune dhe do të doja të diskutonim teknikisht!

Ju lutem, shikoni fushat prioritare të edukimit ligjor të publikut! Ne kemi si fusha prioritare kryesisht reformën në drejtësi, aksesin në drejtësi, qeverisjen vendore dhe targetgrupet janë të rinjtë. Një person i caktuar në Ministrinë e Drejtësisë të bëjë një takim me të gjitha organizatat që punojnë me të miturit, me burgjet, shërbimin e provës e të tjera.

Ju keni projekt me UNICEF-in, me Save the Children, ju keni projekt me Këshillin e Europës, ju keni projekt me OSBE-në dhe mua më mungon ky informacion.

E dyta, keni fushën e grave në zonat rurale. Duhet të bëni një takim me të gjitha organizatat, 100 organizatat ombrellë të grave, duke përfshirë PNUD-in dhe të tjera, që të na sjellin një informacion, ku të përcaktohet viti, emri i organizatës dhe shumën që kanë në dispozicion. Kjo është njohje kontributi, se unë po mendoj që shumë shpejt, besoj nga shkurti, të shkojmë në një konferencë donatorësh.

E treta, duhet të ketë informacione për:

- organizatat e personave me aftësi të kufizuar;
- për projektet lidhur me romët dhe egjiptianët (keni grupin e të rinjve të romëve dhe egjiptianëve dhe ata kanë aktivitete;
- për punëkërkesit (Dajna Sorensen është zëvendësministra që merret me të gjitha projektet, Roveni Voda, gjithashtu. Unë e di sa shumë projekte kanë me JOM-in, me ILO-n e kështu me radhë);
- për azilkërkesit,
- diasporën (ju keni zotin Majko, ministër Shteti, që është superaktiv dhe që ka aktivitete pa fund).

Pra, këtu kërkohen takime bilaterale, koordinim dhe të shënohet çdo informacion në lidhje me këtë çështje dhe aty ku ngecni, mos hezitoni t'i shkruani komitetit, prandaj e ka marrë Kuvendi drejtimin. Ne nuk duam të dublojmë Ministrinë e Drejtësisë, por në këtë mori të ngarkesës që ka Ministria e Drejtësisë mendojmë që detyra e Kuvendit është të ushtrojë kontroll parlamentar për ministrinë që nuk përgjigjen në procesin e konsultimit publik.

Prandaj, kërkon listën e ministrive që nuk kanë reaguar dhe kështu mendoj se do të jemi produktiv.

Ju lutem shumë, secili prej jush të kontribuojë brenda fushës! Ne jemi komitet drejtues, jo për të përfaqësuar thjesht institucionin, por për të bërë diçka më shumë se

institucioni. Nëse ju mendoni, ne mund të thërrasim edhe rrjetin në mbledhje, por nuk është aspak e hijshme që nga rrjeti për të cilin luftuam që kush e kush të ishte, të përgjigjen vetëm 5 institucione.

Iva, do të doja, që, nëse biem dakord, të këtë informacion për rrjetin t'ia vëmë në dispozicion Komitetit Drejtues dhe në emër të rrjetit nëse do më lejoni, unë sot të lëshoj përsëri një letër dhe të gjitha këto do të botohen në faqen e Kuvendit. Të gjithë donatorët do të kuptojnë se ku janë institucionet me transparencën, ku është shoqëria civile me transparencën e projekteve për të cilat ata kanë dhënë paratë. Ky është ai që ne i themi “presioni pozitiv” që mund të bëjmë. Do t'i lançojmë hera herës dhe në konferenca shtypi: sot Komiteti Drejtues mori këto vendime 1, 2 apo 3. Do të shikoni ju më pas, a do të reagojnë institucionet, a do të reagojë shoqëria civile apo jo. Asnjërit nuk i pëlqen të bëhet objekt i debateve në medie për transparencën për gjithëpërfshirjen, për angazhimin. Si mendoni?

Sa kohë kemi, zonja Pregja për të mbledhur informacionet dhe për t'jua vënë ju në dispozicion?

Rovena Pregja – Do të thosha se brenda muajit janar do të ishte shumë mirë që ne të kishim një draft më të mirë nga ky që kemi sot, që do të thotë ta pasuronim me informacione të detajuara, në funksion të aktiviteteve konkrete, kohëzbatimit dhe kostove. Një përgjigje nga të gjitha institucionet që strategjia i njeh përgjegjëse për edukimin ligjor. Kjo mund të bëhet pas thirrjes që ju direkt mund të bëni në adresë të tyre.

Vasilika Hysi – Shumë faleminderit për kohën që na vutë në dispozicion!

Për ta përmbyllur. E para, biem dakord që secili prej nesh që përfaqëson një institucion, të vendosë në dispozicion brenda datës 24 janar, brenda ditës së premtë informacionin për veprimtaritë, aktivitetet të ndara në vite, në muaj mundësisht, të paktën brenda tremujorit të parë, brenda gjashtëmujorit e të tjerë, si dhe donatorin përkatës në planin e veprimit.

E dyta, Ministrisë së Drejtësisë i kërkojmë një kalendar të takimeve bilaterale që do të bëni me secilin institucion. Pse e them këtë? Mund të ndodhë që institucionet nuk janë fare në dijeni të miratimit të kësaj strategjie, të përmbajtjes dhe mendojnë se do të kenë buxhete të veçanta. Jo! Buxhetin që e kanë, punën që tashmë ata e bëjnë në kuadër të projekteve apo të zyrës së Marrëdhënieve me Publikun në shumë institucione ta paraqesin, ta hedhin këtu. Besoj se këtë mund ta bëjë Ministria e Drejtësisë.

Zonja Pregja unë do të doja nga ju brenda ditës së sotme, të më dërgoni listën e ministrisë që nuk i është përgjigjur procesit të konsultimit publik. Biem dakord që në emrin tuaj unë t'i adresoj një shkresë Këshillit të Ministrave. Pra, ministres së Shtetit për

Marrëdhëniet me Parlamentin për t'i tërhequr vëmendjen për moszhvillimin e konsultimit publik sipas ligjit, kërkesave për konsultimin publik. Për dijeni do të vë edhe Kryetarin e Kuvendit. Dakord?

Evis Qaja - Ministria e Drejtësisë si koordinator mund të shprehet, por ne duke ndjekur si dytësor procesin, mendoj se nuk ka pasur deficienca në kuptimin e konsultimit publik. Ndoshta ka nevojë për përmirësimin në nivel teknik për të rakorduar masat që planifikohen në buxhetin afatmesëm për të qenë më korrektë në bërjen e strategjisë.

Ministria e Drejtësisë mund të mbajë një qëndrim më konkret, por ne si Departament i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes duke parë procesin mendojmë se nuk ka deficienca në konsultimin publik, po e ripërsëris.

Rovena Prega - Jam dakord me Evisin në këtë pjesë. Ne jemi në muajin e parë, pra procesi zyrtarisht për draftimin e planit të veprimit ka filluar në mes të muajit dhjetor dhe institucionit i ishte vënë fundi i muajit dhjetor si afat për kthim përgjigjeje. Sigurisht që jo të gjitha kanë kthyer përgjigje. Është ajo që unë thashë më parë. Jemi në mesin e muajit janar, kemi draftin që përmban vetëm kontributet e para aq sa kanë ardhur. Drafti që kemi sot në këtë tryezë do të qarkullojë për një plotësim dhe pasurim të informacionit të tij. Në muajin shkurt jam e mendimit të fillojmë me takimet institucionale. Që të zhvillojmë takimet konkrete ne duhet të kemi një draft shumë të mirë në dorë, që gjatë takimit të diskutohen çështje të mirëfillta teknike përmirësimi, jo që në takim të ulemi dhe të shkruajmë informacionin e munguar. Kjo është çështja që më shqetëson.

Eda Noçka– Kam një propozim. Mund të punohet paralelisht. Pra, takimet bilaterale të shërbejnë edhe për çështjen e përmirësimit, edhe për atë të rakordimit dhe marrjes së informacionit.

Vasilika Hysi - Unë pajtohem me propozimin e Evisit. Këto janë takime informale. Kur shkoni me planin, siç erdhi Iva në zyrën time dhe tha: “Këto janë aktivitetet që janë parashikuar për Kuvendin”. Unë i pashë me vëmendje. Thirra më pas strukturat e projektit, Drejtorinë e Projekteve në Kuvend dhe është më ndryshe. Shumë herë gjërat mund të kalojnë. Mjafton një orientim, 10 minuta apo çerek ore takim. Ndërkohë ju bëni edhe PR-në për institucionin tuaj. Ju mund ta shfrytëzoni edhe për strategjinë ndërsektoriale të të miturve. Unë di që Ministria e Drejtësisë është në kuadër të hartimit të planit të punës për vitin 2020, apo jo? Me këtë rast bëni këtë punë, me një vajtje mund të zgjidhni shumë probleme të tjera. Kjo është një përvojë që unë do ta vlerësoja dhe më ka rezultuar në praktikën time personale shumë më e dobishme sesa *e-mail-et*.

Duhet të bëhet një takim me zotin Bekim Murati. Ai mund të thërrasë Këshillin Konsultativ të organeve të qeverisjes vendore. Unë ndërkohë do të vë në dijeni edhe Nënkomisionin për Qeverisjen Vendore që drejton zoti Fino, që është në varësi të Komisionit të Ligjeve për t'i inkurajuar, se ata kanë aktivitete, ndoshta nuk kanë kapacitetet ose nuk i kushtojnë vëmendje se çfarë duhet të bëjnë, si dhe një takim me organizatat e qeverisjes vendore, me kryetarët e bashkive. Kemi dy shoqata, me të të dyja duhet të zhvillohen takime.

Shoqatat janë të pavarura, por nëpërmjet Bekimit ju mund të bëni një koordinim. Janë anëtare të rrjetit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eda Noçka - Sapo erdhi shkresa nga Ministria e Drejtësisë, unë shpërndava edhe strategjinë, komentet përkatëse dhe udhëzimet. Nuk është se nuk kishin njohuri, të paktën pjesa e pushtetit vendor, por pjesa tjetër, e di që kanë aktivitete të planifikuara, bëjnë përditë fushata, fletëpalosje kishin vështirësi në vendosjen e masave konkrete në plan. Mendoj se u mungonte informacioni. Prandaj ndoshta është i rëndësishëm takimi. Mjaftoheshin me atë: “Ne nuk kemi komente”. Unë nuk kam kthyer përgjigje, se i binte që të thosha: jemi dakord me planin. Prandaj nuk dërgova përgjigje.

Vasilika Hysi - Faleminderit!

Iva, kam një pyetje. Rrjeti duhet të organizohet në organe të thjeshta dhe unë e di që anëtarët e Rrjetit kanë shprehur interesin në cilat organe duhet të bëjnë pjesë. A janë konstituar apo jo organet e rrjetit, sepse nuk e mbaj mend, dhe a mund ta thërrasim Rrjetin?

Iva Seseri- Kemi kërkuar informacion lidhur me interesin që kanë për t'u angazhuar sipas objektivave që ka strategjia dhe kanë kthyer përgjigje. Në bazë të këtyre do të bëhet grupimi në katër grupe sipas objektivave, nuk janë konstituar, por që në mbledhjen më të parë të Rrjetit ose, nëse do të jetë e nevojshme, edhe pa u mbledhur Rrjeti, të dalë automatikisht se cilat janë institucionet që të mblidhen grupet në vazhdim.

Vasilika Hysi- Shumë faleminderit!

A mund të bëjmë konstituimin e katër organeve koordinuese, zbatuese të...

Iva Seseri – Nuk mund t'i quajmë organe të mirëfillta, por grupe.

Vasilika Hysi- Grupe pune.

Iva Seseri- E kemi parashikuar që mund...

Vasilika Hysi- Javës tjetër të vëmë në dijeni komitetin, t'i mbledhim në takime veç e veç dhe të kërkojmë angazhimin e Rrjetit për të dhënë komente dhe sugjerime. Si mendoni, sepse edhe rrjeti mund të kontribuojë? Për shembull, marrin rastin e Urimit, ku AMA ka aktivitete pa fund...

Rovena Pregja - Meqenëse u përmend AMA, dua t'ju them se është një nga institucionet që ka kthyer përgjigje, por thjesht thonë që jemi dakord, e mbështesim edukimin ligjor dhe kaq, por kjo nuk mjafton në funksion të dokumentit.

Vasilika Hysi – Unë përsëri këmbëngul tek takimet bilaterale.

Blerta Xhako- Unë quhem Blerta, Komisioneri për të Drejtën e Informimit. Unë personalisht e mora Rovenën në telefon dhe e pyeta nëse mund të shtojmë aktivitete të tjera përveç atyre që janë parashikuar në plan. Kam përshtypjen se shumë nga institucionet ndoshta janë nisur vetëm nga fakti se çfarë është parashikuar këtu dhe kanë kthyer përgjigje vetëm nëse janë ose jo dakord. Mos ndoshta duhet ta dinë se çfarë aktivitete të tjera keni në kuadër të punës ose çfarë mendoni se duhet të shtojmë?

Erzen Tola- Në vijim të diskutimeve, unë mund të garantoj një takim me IZHA-n për ta kuptuar edhe ata këtë plan të ri veprimi, në bazën e kësaj strategjie dhe për ta rakorduar me veprimtaritë dhe planin e tyre të punës. Tani është koha që mund të ndryshojmë edhe planin e tyre të punës që ta kemi të koordinuar. Pa bërë një takim unë nuk mund t'i sqaroj ata dhe as ata e kuptojnë se çfarë po bëjmë ne.

Iris Aliaj – Dua të bëj një sugjerim. Me qëllim që ne të shpëtojmë sa më shumë kohë, mendoj që ne, si ministri, mund të organizojmë një aktivitet të përbashkët me të gjitha institucionet, ku t'u shpjegojmë planin e veprimit dhe pastaj të vazhdojmë të koordinohemi nëpërmjet emaileve, jo vetëm me institucionet shtetërore, por edhe me organizatat e shoqërisë civile. Jam shumë dakord me sugjerimet që dhatë për Ministrinë e Drejtësisë, sepse, siç e përmenda edhe më parë, ne, si ministri, jemi duke organizuar një sërë aktivitete edhe me organizatat e shoqërisë civile, të cilët ofrojnë shërbime që lidhen me çështjen e aksesit në drejtësi apo me të miturit dhe çështjet që ne kemi ngritur për diskutim nuk janë një, por janë disa në të njëjtën kohë. Kështu që ne mund të vazhdojmë dhe të ecim në këtë kuadër. Ne do të koordinohemi me Rovenën, me qëllim që të organizojmë një takim sa më të shpejtë. Jam shumë dakord që çështjet duhen diskutuar, sepse nëpërmjet emaileve jo të gjithë, edhe për shkak të kohës dhe ngarkesës që kanë institucionet, nuk arrijnë të kuptojnë se çfarë duhet të bëjnë dhe se cili është...

Vasilika Hysi- Çfarë roli keni në ministrinë e Drejtësisë, ju lutem?

Iris Aliaj- Unë jam këshilltare e Ministres së Drejtësisë dhe mbuloj çështjet që lidhen me reformën në drejtësi, aksesin në drejtësi, të miturit dhe ndërmjetësimet.

Vasilika Hysi- Iris, meqenëse ju jeni pikërisht te ministria, e cila është përgjegjëse për hartimin e planit dhe ju keni disa drejtori aty që punojnë, a mund të bëni takime mes jush dhe kur t'i bëni këto takime me donatorët dhe me partnerët në ngritjen e Rrjetit të Edukimit

Ligjor e të tjerë të merrni edhe listën e aktiviteteve dhe të angazhimeve? Unë e di që ministria juaj zhvillon shumë aktivitete, prandaj bëni inventarin e nevojave që keni dhe në një mbledhje merrni informacion për strategjinë. Ju keni projekte me OSBE-në për ekstremizmin dhe radikalizmin, të cilat janë pjesë e edukimit ligjor.

Iris Aliaj- Po, ne kemi një sërë programesh.

Vasilika Hysi- Atëherë, Iva dhe ju të nderuar kolegë, a jenë dakord që javën që vjen ne t'ju dërgojmë listën e riorganizimit të Rrjetit dhe në emrin tuaj unë t'i dërgoj edhe një herë Rrjetit një letër, ku t'i themi që të shprehet jo thjesht për planin e veprimit, por të shtojnë në planin e veprimit listën e aktiviteteve që ata planifikojnë, me afate të mirëpërcaktuara jo me ditë, por me afate 3-mujore, 6-mujore apo 9-mujore me buxhetin dhe donatorin e mundshëm? Aty do të shikoni sa fonde ka për të njëjtën fushë.

Ne kemi marrë zyrtarisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve listën e organizatave të regjistruara, koordinatori i Shoqërisë Civile në Kuvend ka përgatitur listën e të gjitha organizatave të pajisura me Nipt, që janë aktive me fushën e veprimit, dhe ne po përditësojmë edhe regjistrin. Nuk e kemi bërë publik, sepse kemi kërkuar sot opinionin e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale se çfarë mund të publikojmë në faqen e Kuvendit në lidhje me të dhënat e organizatave, por pa marrë përgjigjen e komisionerit Dervishi nuk e bëjmë dot publike dhe nuk e shpërndajmë dot, por për efekt të punës sonë ne e kemi dhe, në këtë kuadër, ne do të kontaktojmë edhe nëpërmjet mekanizmave tanë. Kjo ishte një kërkesë imja dhe do t'ju vë në dispozicion çdo informacion të lejuar, duke mbrojtur të dhënat personale.

Lidhur me shqetësimin që keni për identifikimin e institucioneve, zonja Pregja, më ka rënë në sy që Kuvendin dhe Rrjetin e keni vënë kudo, por ne jemi koordinues dhe nuk mund të jemi zbatues. Kur kemi hartuar strategjinë dhe e kemi miratuar në Kuvendin e Shqipërisë, rolin kryesor ia kemi lënë Ministrisë së Drejtësisë, pra është Ministria e Drejtësisë dhe ne këtu kemi më shumë punë menaxheriale, bashkërendimi dhe bashkëveprimi, ku secili prej nesh, po flas në emër të Kuvendit të Shqipërisë, kemi pjesën e edukimit ligjor tonin. Po ju njoftoj se javën që vjen ne kemi aktivitete sensibilizuese për Kuvendin e Shqipërisë, është 100-vjetori i parlamentarizmit dhe dita e enjte është dita e dyerve të hapura të Kuvendit të Shqipërisë, ku i gjithë stafi do të prezantojë Kuvendin, nismat ligjore dhe procedurat. Pra, ky është një edukim ligjor, që do ta vëmë në vazhdimësi edhe me buxhetimet, por për gjëra të tjera, këtu dua ndihmën e Edës, si për shembull, krijimin e *website*-s nuk mund ta bëjë Kuvendi i Shqipërisë, sepse secili do të bëjë në faqen e vet linkun e vet me të gjithë

informacionin, pasi ne kemi programin e transparencës. Prandaj, Eda, unë dua një informacion më shumë si është ideuar, meqenëse ka qenë...

Eda Noçka – Ne kemi propozuar që të bënim takime të përbashkëta, qoftë edhe për të ditur se çfarë kemi diskutuar ne në grupin e punës. Faqja e Kuvendit, faqja e Rrjetit është konceptuar si një faqe e posaçme e Rrjetit të Edukimit Ligjor. Ne kemi menduar që kjo faqe të ishte pjesë e faqes së Kuvendit, pra të kishte një ikonë, ku të ishte faqja e rrjetit dhe të gjithë qytetarët të kishin akses në informacion, ku të gjitha portalet, që ofrojnë informacion ligjor, si nga organizatat, ashtu edhe nga institucionet publike të mbledhemi të gjithë informacionin në rubrikat e posaçme të *web-it* të Rrjetit dhe të krijonin një akses të përgjithshëm. Domethënë, duke evituar që qytetari të shkonte dhe të klikonte në faqe të posaçme, pra i gjithë informacioni të mbledhej te rrjeti. Rrjeti të publikonte edhe veprimtarinë e tij dhe të gjithë realizimin e planit të veprimit dhe të strategjisë dhe, natyrisht, i është lënë si përgjegjësi Kuvendit, duke qenë se është faqja e Rrjetit të Edukimit Ligjor të Publikut.

Vasilika Hysi – Teknikisht nuk e di se sa kjo gjë mund të realizohet në faqen e Kuvendit. Faqja e Kuvendit është në ristrukturim, pasi, në kuadër të rritjes së transparencës dhe të asaj që ne themi të gjitha ligjet dhe projektligjet që nga momenti i inicimit deri në miratim do të futen në faqen e Kuvendit me të gjitha komentet, sugjerimet dhe përditësimet. Pra, ka një qasje tjetër të faqes së parlamentit. Ne do të pyesim. Iva, do të flasim se sa kapacitet ka faqja. Unë e kisha menduar linkun e faqes së Kuvendit ku do të hidhen aktivitetet e rrjetit, vendimmarrjet, planin e veprimit, strategjinë, raportet që ne do të nxjerrim, rekomandimet, por nuk besoj se mund të mbajmë më tepër se kaq.

Anisa Metalla – Nëse mund të shkoj diçka nga përvoja që kemi, të paktën me portalet, pra po themi për ndihmën ligjore që ofrohet përmes internetit. Ajo kërkon goxha mirëmbajtje, sidomos në qoftë se faqja do të jetë burim informacioni. Të paktën në grupin draftues ideja e kësaj faqeje ishte që të ishte më tepër një faqeje lidhëse. Duke qenë se Kuvendi mund të krijojë këtë hapësirë, ku jepen informacione për edukimin ligjor, aktivitetet që kryhen, njëkohësisht, mund të krijojë lidhje me portalet që tashmë ekzistojnë. Pra, pritshmëria e draftuesve nuk ishte që Kuvendi të krijonte...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ligjet ndryshojnë, ne duhet ta përditësojmë informacionin ligjor, format... Për shembull, ne kemi një portal, por kemi shumë mundim për ta mirëmbajtur. Sigurisht, shpeshherë përpiqemi ta bëjmë në mënyrë vullnetare, sepse tashmë e kemi aty, por jo gjithmonë gjejmë donatorë që mund ta buxhetojnë punën që bëhet për mirëmbajtjen e portalit. Faqja aty mund të shërbejë si urë lidhëse. Për shembull, faqja e Komisionerit,

gjithashtu ka shumë informacion të vlefshëm. Mjafton që dikush, i cili ka një informacion, dëgjon një qytetar që Kuvendi bën diçka për të më informuar mua si qytetar, klikon aty: “Shiko se qenka edhe ky institucioni tjetër” dhe lidhet atje. Domethënë, kjo ka qenë ideja.

Vasilika Hysi – Jam shumë dakord, Anisa. Ne e kemi këtë shqetësim. Unë i vizitoj shpesh faqet tuaja dhe disa herë janë të përditësuar, disa herë nuk janë, disa herë janë më mirë dhe disa herë jo mirë, sepse kërkon kapacitet. Edhe ne në Kuvend nuk arrijmë të hedhim çdo gjë. Kjo mbledhje, ky procesverbal do të marrë kohë për t’u zbardhur, duhet miratuar, pastaj do të hidhet në faqe. Pra, ka edhe ajo kohën e saj për të bërë transparencën.

Megjithatë, ne do ta diskutojmë. Mendoj se duhet të kemi një takim të posaçëm për të folur për punën e Rrjetit. Ndoshta Rrjeti, mund të na sqarojë se sa të përditësuara janë 35 institucionet. Pra, a e kanë pasuruar, a e kanë futur në faqen e tyre? Çdo institucion ka faqen e transparencës së tij, ku jep informacion si aplikon për vizë, si aplikon për të marrë kartën e identitetit, si mund të aplikosh për urdhër mbrojtjeje, si mund të aplikosh për ndihmë juridike, pra i kemi të gjitha. Ne do të flasim me IT-në tonë, nëse mund të bëjmë një lidhje të lidhjeve të linkut.

Urdhëroni, zonja Blerta!

Blerta Xhako – Zonja kryetare, unë ju njoftova edhe me *email*, që ne pa u miratuar plani hapëm një sesion në faqen tonë zyrtare për Strategjinë e Edukimit Ligjor dhe Publikut. E kemi përdorur për të hedhur strategjinë. Të gjitha dokumentet që do të miratohen këtu...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do të pyes, sepse nuk e kam parë. Kam gati dy javë që nuk kam folur me IT-në, por do ta shikoj.

Evis Qaja – Zonja Kryetare, ju e dini për shkak të ligjit të njoftimit dhe të konsultimit publik është Regjistri Elektronik për Konsultimin Publik. Ai përdoret si regjistër për të gjithë institucionet qendrore, në fakt, por jo vetëm. Dua të sugjeroj diçka. Qoftë dhe në fazat e hershme ai regjistër shërben për konsultimin publik, në të cilin ne aty kemi mundësi për të parë dhe për të bërë analizë sa kanë vizituar draftin e dokumentit. Nëse kanë komente, mund t’i analizojmë dhe t’i përcjellim komentet. Ministria e Drejtësisë ka një koordinator të përcaktuar për konsultimin publik që hedh në regjistër. Do të sugjeroja që ta hidhnin, sepse e kanë shumë më të lehtë, qoftë në këtë kanal komunikimi këtë trakt, pra se sa vizitorë ka. Domethënë, është shumë e strukturuar dhe në mënyrë analitike se si jepet informacioni, i cili do të na shërbejë të gjithëve, edhe në të tavolinës së diskutimit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eda Noçka – Në këtë fazë mund të hidhet drafti te Regjistri i Konsultimit Publik? Sepse zakonisht aty hidhen vetëm aktet drejt përfundimit.

Evis Qaja - Derisa drafti është aktualisht i publikuar nga komisionari, Blerta na informoi që e ka hedhur, apo jo?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vasililka Hysi – Një nga shqetësimet që ngrenë përfaqësuesit e shoqërisë civile, ekspertë dhe akademikë, është se nuk njoftohen në kohë për projektaktet dhe koha, që u lihet në dispozicion, është relativisht e shkurtër, 15 ditë dhe në rastet e ligjeve të komplikuar deri në 30 ditë. Unë nuk i di rregullat që ka Regjistri i Konsultimit Publik në çfarë faze hidhet një projekt. Por, nëse ne duam të kemi sa më shumë angazhim, të jeni të bindur që nuk do të na mungojë procesi gjithëpërfshirës, por nuk ka shkuar informacioni tek institucioni dhe personat e interesuar. Ndaj, dua të bëj një sugjerim: mundemi ne të gjithë që jemi në tavolinë të fillojmë një fushatë që sot, nëpërmjet rrjeteve sociale, kontakteve *email*-ve që keni, që të thuhet Ministria e Drejtësisë ka përgatitur projektin e Planit të Veprimit për Strategjinë e Edukimit Ligjor, pra kërkohet kontributi i secilit prej jush:

Së pari, në listën e aktiviteteve që planifikon të zhvillojë në vitet 2020, 2021, 2022 dhe 2023.

Së dyti, kush është donatori, koha e përafërt dhe donatori që planifikohet... Njëkohësisht, ju thoni: jemi të gatshëm që t'ju japim çdo informacion, nëse keni pyetje ose kërkoni informacion shtesë. Nëse dëshironi për fushat për t'u orientuar planin strategjikë e gjeni në këtë faqe ose, nëse nuk e gjeni, na kontaktoni direkt për t'jua përcjellë. Mua disa ma kanë kërkuar t'jua nis *online* dhe unë e kam bërë edhe pse kam 1 mijë detyra si zëvendëskryetare e Kuvendit, nuk kam përtuar t'jua nis dhe të komunikoj me ta. Ndërkohë, sekretariati, koordinatorja për shoqërinë civile, zonja Manjani, të kontaktojë me të gjitha organizatat që janë akredituar, por, njëkohësisht, edhe me grupin e medieve të akredituara për t'u thënë që rrjeti është në konsultim të planit, që është një plan fillestar. Pra, që të mos kemi vërejtje apo kritika, të kuptojmë që ky është final, është shumë fillestar, por ne do të donim çdolloj kontributi apo çdolloj sugjerimi nga ana juaj. Të jeni të bindur se edhe mediet investigative do të japin komente, sugjerime. Edhe në qoftë se nuk do të japin, mendja e tyre do të hapet, do të fillojnë të bëjnë programe televizive, intervista... Do t'ju kërkojnë intervista juve, mua e të tjerëve. Kështu, do ta hapim dhe do ta bëjmë më gjithëpërfshirës procesin.

Biem dakord?

Rovena Pregja – Në lidhje me procesin, kjo është pjesa e metodologjisë që ne ndjekim praktikisht kur hartojmë dokumente të tilla strategjike. Pra, komunikimet me *e-mail*,

që ne i përmendëm, si të thuash, me njëri-tjetrin, pasohen nga aktivitete të tilla publike apo edhe online. Unë e them këtë edhe nga eksperiencia e programeve apo e planeve të tjera të veprimit që ndjek Ministria e Drejtësisë, që janë vazhdimisht të publikuara në faqen tonë. Kështu që...

Evis Qaja – Faleminderit, zonja kryetare!

Unë bie shumë dakord me ato që sugjeroi kryetarja, por edhe me ato që po thotë Rovenë që është pjesë e kuadrit metodologjik.

Në kuadër të hedhjes së dokumentit, do të sugjeroja të hidhet edhe te regjistri elektronik, i cili parashikon në çdolloj faze, qoftë edhe të hershme si koncept-ide...

(Deputetja Hysi flet pa mikrofon.)

Pikërisht. Por, ju lutem, hidheni, sepse ne jemi edhe nën monitorimin për konsultim publik. Kështu që mund ta bëjmë.

Vasilika Hysi – Për ta mbyllur, meqenëse sekretariati ngarkohet me shumë detyrime, unë do të doja një përfshirje të të gjithëve, brenda funksionit të mandatit që keni.

Nuk dua të bëhem e bezdisur, por e kam merak: që sot të përdorim të gjitha mënyrat e komunikimit elektronik, lidhjet shoqërore, miqësore, zyrtare që kemi, për t'i thënë që ministria ka përgatitur këtë draft fillestar, në respekt të ligjit “Për konsultimin publik”, duke respektuar të drejtën e publikut për të marrë pjesë që në hapat e parë të draftimit.

E dyta, listoni çdo aktivitet që ju mendoni të bëni në kuadër të donatorëve, është edhe PR për organizatën dhe për donatorët e të tjerë.

Ju lutem, adresojeni te rrjeti në adresën e sekretariatit në formë shkresore.

Ju lutem, përveç institucionit tuaj që duhet të përgjigjet patjetër (më vjen keq që shumë nga institucionet që ne përfaqësojmë nuk i kanë bërë në formën më të mirë të mundshme), ta bëjmë këtë brenda datës 24 janar, që është ditë e premte.

E fundit, sugjeroj, në qoftë se ju bini dakord, të thërrasim “Rrjetin”, sa ta vëmë në lëvizje, por paraprakisht Rrjetit t'i bëjmë edhe një herë një njoftim për të dhënë komente, duke e sqaruar që jo të komentojë nëse drafti është i mirë ose jo, por për të shtuar, për ta pasuruar...

Ju, Anisa dhe Evda, me shoqërinë civile besoj, në emër të Rrjetit, mund të kontaktoni me organizatat e shoqërisë civile dhe të na bëni një mbledhje të informacionit; ministria me institucionet, bashkë me Kryeministrinë, si dhe ne, Kuvendi, me institucionet e pavarura kushtetuese dhe të krijuara me ligj.

Ndërkohë, Alma, të lutem, nuk duhet të lëmë jashtë vëmendjes qeverisjen vendore; është më e rëndësishmja. Ata janë në kontakt të përditshëm me qytetarët. Nëse ju dëshironi,

një takim mund ta bëjmë së bashku me zotin Murati, me Bekimin, dhe me dy organizatat, me shoqatat, ku te njëra është Adelina dhe, mos gaboj, tek tjetra është Voltana Ademi. Duhet takuar... Edhe ato kanë interes. Madje unë di se ka shumë aktivitete në nivel vendor, se ne i marrim informacionet zyrtarisht në kuadër të kontrollit parlamentar. Pra, mungon një koordinim. Biem dakord?

Kjo ishte një mbledhje disi e gjatë, por mendoj se duhej sqaruar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kalojmë tani te njohja me rezultatet e votimit.

Sikurse jeni në dijeni, të nderuar kolegë, për anëtarët e Bordit Këshillimor të Rrjetit Kombëtar për Edukimin Ligjor të Publikut, kishin shprehur interesin 18 anëtarë dhe anëtare. Komisioni i ngritur me përbërjen e Desara Dushit, Arlinda Dinit dhe Edlira Ramës ka numëruar fletët e votimit.

Në përfundim të procesit të votimit për zgjedhjet e anëtarëve të Bordit Këshillimor të Rrjetit Kombëtar të Edukimit Ligjor të Publikut, pas verifikimit të fletëve të votimit nga komisioni i caktuar, rezultoi se kanë votuar gjithsej 11 anëtarë të Komisionit Drejtues, një fletë votimi konsiderohet e pavlefshme, pasi është votuar vetëm për 2 kandidatura nga 5 që duhej të votoheshin.

Nga numërimi i votave të vlefshme kandidatët me më shumë vota janë si më poshtë: zonja Alma Hicka me 9 vota, e cila përfaqëson Shkollën e Magjistraturës; zonja Enkeleda Olldashi me 8 vota, e cila është pedagoge në Fakultetin e Drejtësisë (Universiteti i Tiranës); zonja Mirela Bogdani me 8 vota, e cila është, gjithashtu, pedagoge në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës; zonja Nadia Rusi me 5 vota, e cila është, përsëri, pedagoge në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës; zonja Zhaklina Peto me 4 vota, pedagoge në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, si dhe zonja Migena Leskoviku me 4 vota, pedagoge në Fakultetin e Historisë së Universitetit të Tiranës. Pra, nga kandidaturat e votuara me më shumë vota katër prej tyre shpallen fituese. Për vendin e pestë rezultoi numër i barabartë votash ndërmjet dy pedagoqeve, zonjës Peto dhe zonjës Leskoviku.

Në rastin kur për vendin e pestë kemi barazim votash, besoj që duhet një votim i dytë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka një rivotim.

Shumë faleminderit!

Sekretariati ka përgatitur fletët e votimit, i cili është më i thjeshtë dhe më i shpejtë. Kështu që, shpejt e shpejt, ju lutem, të gjithë!

(Fillon rivotimi)

Kandidaturat janë zonjat Zhaklina Peto dhe Migena Leskoviku.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, zoti Rusi.

Ilir Rusi – Se juristët kanë logjikën dhe logjika shkon te matematika. Ju thatë se janë dhjetë fletë votimi të vlefshme.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vasilika Hysi – 11 fletë votimi.

Ilir Rusi – Me një të pavlefshme mbeten dhjetë, me pesë vota bëhen 50 vota. Po t'i mbledh këto kandidatura... Ka kandidatura të tjera me më pak vota?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Por duhet t'i thoni pra të gjitha.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vasilika Hysi – Ndoshta në procesverbal, për transparencë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka një gjë. Unë mendoj që për ata të cilët nuk kanë marrë vota nuk është mirë të afishohet në faqen e Kuvendit që, për shembull, Vasilika Hysi ka marrë 2 vota ose Evisi ka marrë 3 vota.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për transparencë ne mund ta themi, por a do të ndiheshit mirë ju, në qoftë se do të ishit kandidat dhe në faqen e Kuvendit ose në një faqe zyrtare që klikohet të keni...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Rusi – Zonja kryetare, e kam për efekt të votimit; për vlerën matematikore.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Se mund të jetë ndonjë votë këtu dhe të mos bëjmë kot një votim. Këtë doja të thosha.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në këtë sens...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vasilika Hysi – Iva, numrin 5 të bordit e kemi caktuar në ndonjë akt nënligjor?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kemi marrë vendim komisioni.

(Diskutime pa mikrofon)

Të nderuar kolegë,

Nga votimi rezulton se Migena Leskoviku ka marrë 7 vota, kurse Zhaklina Peto ka marrë 3 vota. Pra, kandidatura e pestë është Migena Leskoviku. Ju lutem, bëni gati vendimin. Atëherë, biem dakord që procesverbali do të zbardhet dhe do të futet në faqen e rrjetit.

Ndërkohë, sot duhet të bëjmë një njoftim për shtyp ku të thuhet se u zhvillua mbledhja e Komisionit Drejtues të Rrjetit ku u diskutua dhe u miratua rregullorja për organizimin, u bë vlerësimi dhe zgjedhja e anëtarëve të bordit këshillimor si dhe të thuhet se çfarë përfaqëson bordi dhe kush u zgjodh. Gjithashtu, të bëhet njoftimi me *e-mail* i anëtarëve fitues, si dhe të njoftohet rrjeti për procesin dhe emrat që kanë dalë. Për sa i përket pikës 3, diskutuam mbi planin e veprimit të Strategjisë së Edukimit Ligjor për Publikun dhe komiteti drejtues vendosi të rihapë procesin e konsultimit publik. Projektplanin i veprimit të hidhet në regjistrin e konsultimit publik. E treta, komisioni drejtues t'i drejtohet edhe njëherë rrjetit për të tërhequr mendimet dhe sugjerimet konkrete për disa çështje.

Gjithashtu, të bëjmë një thirrje publike ku të ftojme të gjitha grupet e interesuara të shprehen. Për çdo person që do të konsultohet, strategjia dhe projektplanin gjendet në linkun e Ministrisë së Drejtësisë. Në qoftë se ne e kemi edhe në linkun tonë, e vëmë edhe te linku ynë. Gjithashtu, të vendoset edhe njoftimin se presim komente deri në këtë datë.

Pastaj, të gjithë, shoqërisht, privatisht, miqësisht, zyrtarisht, sot duhet të “bombardojmë” të gjitha adresat e organizatave dhe partnerëve që kemi, vendas dhe ndërkombëtarë. Ndërkohë, koordinatorja jonë e shoqërisë civile të njoftojë të gjithë rrjetin për të parë kush ka interes. Dakord?

Unë ju falënderoj për kontributin e dhënë në mbledhjen e sotme! Kam besim se ne do të bashkëpunojmë shumë mirë dhe me miratimin tuaj do të thërrasim mbledhjen e rrjetit për të bërë konstituimet e grupeve të punës, por edhe për t'i tërhequr edhe njëherë vëmendjen. Që të jesh në rrjet është privilegj, por ka edhe detyrime. Nuk mund t'ia lëmë çdo gjë qeverisë apo ministrisë.

Ndërkohë, unë mendoj të konsultohem edhe me Kryetarin e Kuvendit për projektet. Gjithashtu, mendoj të thërrasim edhe një tryezë, qoftë edhe një kafe mëngjesi, me donatorët që punojnë në fushën e edukimit ligjor. Duke parë edhe kontributin që do të japin, pse jo, t'ia bëjmë edhe pak transparente se si punojnë të gjitha organizatat dhe partnerët që ata mbështesin financiarisht. Është e nevojshme për të pasur transparencë dhe llogaridhënie.

Faleminderit dhe ditë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretare Ina Jano

Këshilltare Edlira Rama